

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetae "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 188, Qershor 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

'STATURA MORALE...!' E DOMOSDOSHMIJA E ANASHKALUAR

Asnjëherë nuk kam qenë dakord me përkufizimin e ngushtë, që i është bërë termit 'moral'. Me vetëdije të plotë, në ato biseda që kam pasur me miq e më tepër, kam këmbëngulur që tek ty term të përfshihen një sërë vesesh ekstra-negative të karakterit të njeriut, duke përfshirë familjen, sjelljen, shkollimin, ndershmërinë, moralin, bujarinë, komunikimin dhe sidomos të ashtuquajturën 'staturë morale individuale' e cila në këndvështrimin tim, përbën pasaportën përfaqësuese në shoqëri, ...


2

PYESIN MALET E DUKAGJINIT: PSE E AKUZONI KËTË FARË TRIMI?

REAGIM DHE PËRGJIGJE PËR FASHISTËT SHQIPTAR ARGON TUFJA E ÇELO HOXHA DHE TËRË MBËTJEVE SEPTIKE TË NAZIFASHISTËVE, NGA NIPI I "KRIMINELIT" ME NUMËR 65 NË LISTËN E NJË PSEUDOINSTITUTI KUPLARAJE, ANTISHQIPTAR.

Nga: Ndoc Logu

Jo vetëm pas ndarjes nga jeta reth 30 vjet të kaluara, por edhe më parë, shumë shokë, miq, dashamirës dhe bashkëkohës të Gjon Marashit, më kanë kërkuar disa herë të shkruaja një monografi ku do të trajtoj atij, ku të shkrihet e tërë historia e kësaj familje në 200 vjetet e fundit. ...



13

DHURO DASHURI E PËRKUJDESJE

Është krijuar traditë që çdo fund viti, në shkollën 9 vjeçare Bardhaj të zhvillohen veprimtari të ndryshme me karakter edukativ, të cilat i shërbejnë edhe prapësisht mësimor. I tillë ishte edhe ai i 30 majit 2019, me moton: "Dhuro dashuri e kujdesje", një veprimtari sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të familjes.

6

VAJZAT SI "SHOTA"

Klodjana Serraj - Të gjithë e njohim Shotën, një heroinë me veshje mashkullore që luftoi për shumë vite për çlirim dhe bashkim të trojeve Shqiptare, e që gjithsesi mbetej femër, nëse kthehemi pas në kohe kemi edhe mbretëreshën Teutë ku perandoria Ilire në sundimin e saj ishte më e fortë. Ato janë simbol të heroinave por edhe Shotat e Teutat e ditëve të sotme nuk ndryshon shumë nga ato, por ne e kemi zbuluar rolin e tyre në rëndësinë dhe vlerat që ato kanë dhe statistikat për keqtrajtimin ...

8

GJERGJ LEQEJZA, E GËZOSH "DEKORATËN E ARTË TË NDERIT PËR SHËRBIM NDAJ REPUBLIKËS SË AUSTRISË

Me 19 qershor 2019, në mjediset e Qendrës Rinore "Arka", në Shkodër u organizua ceremonia e dekorimit të bashkëpunëtorit e mikut tonë, Gjergj Leqeja - konsull i Republikës së Austrisë për veriun e Shqipërisë, me qendër në Shkodër.

Ceremoninë e hapi Marjan Lukani, i cili pasi prezantoi ceremoninë, tha: "Në këtë ditë"



3

AGUSTIN ARAMADHI, MODELI I QËNDRIMTARIT PËRBALLE VËSHTIRËSIVE

Shoqëria jone ka nevojë për individ që janë model në jetën tonë të përditshme, që transmetojnë pozitivitetin e mirësi, janë aktiv dhe japin shprehje, tregojnë rrugën përmes shembullit të tyre, si mund të përballohen vështirësitë, hallet dhe problemet e jetës, duke parë vetëm përpara.

Njerëz të tillë ka kudo, në çdo mjedis, në fshat e qytet. Por një i veçantë, një luftëtar këmbëngulës, që e do jetën, sido që të vijë është i riu Agustin Kol Aramadhi. Komuniteti jonë dukagjinas, përmes gazetës tonë, por edhe më gjerë duhet të njihet me këtë model qendrestari. Për këtë menduam të shkruajmë për atë çfarë dëgjuam nga goja e tij.



EFEKTET KOLATERALE TË TELEVISIONIT NË TRURIN E NJERIUT

Suela Ndoja - Në median vizive të gjithë shohim dhe dëgjojmë informacione të ndryshme (fenomene negative si vrasje, dhunë fizike, divorce, krime, përdhunime, lëndëve narkotike, politike etj) të cilat prodhojnë efekte të ndryshme ...

12

'STATURA MORALE...!'

E DOMOSDOSHMIJA E ANASHKALUAR

Asnjëherë nuk kam qenë dakord me përkufizimin e ngushtë, që i është bërë termit 'moral'. Me vetëdije të plotë, në ato biseda që kam pasur me miq e më tepër, kam këmbëngulur që tek ty term të përfshihen një sërë vesesh ekstranegative të karakterit të njeriut, duke përfshirë familjen, sjelljen, shkollimin, ndershmërinë, moralin, bujarinë, komunikimin dhe sidomos të ashtuquajturën 'staturë morale individuale', e cila në këndvështrimin tim, përbën pasaportën përfaqësuese në shoqëri, si për mua, për ty, e për të gjithë individët e një shoqërie në bashkëlidhje, përmes aspekteve të ndryshme qofshin ato gjeografike, fizike, racore, kulturele, historike e shumë të tjera.

Ajo, që unë kam vënë re gjatë këtyre viteve është, thuajse, rishtuese. Sot, nuk besoj të gjendet ndonjë njeri i cili nuk e pranon, apo administron fakte në kundërshtim të tezës: Ky vend, fatkeqësisht, sundohet administrativisht nga një pjesë 'pakice' me staturë më imorale të shoqërisë sonë! Kjo pjesë, sundimtare, nuk i ka kapacitetet e të menduarit në heshtje, nuk njohin 'skuqjen', siç thoshte Shekspiri: O turp ku e ke skuqjen?!, nuk kanë 'ekran' të shëmbëllimit të vetvetes. Konceptin, detyrë, familje, moral, ndershmëri, prosperitet, shoqëri, aftësi, meritë... e shumë e shumë të tjera i kanë nxjerrë jashtë fjalorit përditësor të tyre dhe aq më tepër jashtë veprimtarisë së tyre ditore.

Në këto kushte, me dashje apo pa dashje...kjo varet nga shkalla shumë e ulët e inteligjencës së tyre, po përcjellin vetveten tek brezat pasardhës. Atëherë, mund ta them me shumë bindje: Këta janë varrmihësit e brezave të ardhshëm, janë varrmihësit e një harte në formën e një shuplake, që mban emrin SHQIPËRI, të cilës me padhëmbshuri i japin çdo ditë shuplaka "vdekjeprurëse!" Këta tipa mbahen si: Sundimtar, elitat, fitimtar; komandant, dijetar... e ku ta di unë, ndër kohë, që për fatin më të keq, në të vërtetë janë përfaqësuesit më shëmtarake të 'staturës morale e shoqërore' në të kaluarën e tyre dhe tani.

E keqja më e madhe qëndron në faktin se, në 'ekranet' e tyre, jo vetëm që nuk mund të stimulohet lindja e fillesave njerëzore, por në të kundërtën në ato 'ekrane' gjenden të gatshme të gjitha habitatet e regresit, që siç njihet edhe nga psikologjia e përvoja njerëzore: Regresi është i mirëfilltë në çdo kohë! Asnjë sferë e jetës sonë shoqërore nuk i ka shpëtuar kësaj 'race, që shkatërrojnë në thelb

shoqërinë tonë njerëzore.

Ata dhe ato i gjen në administratë, shëndetësi, kulturë, e ma e papranueshmja: në arsim!

Si mund t'i shërbeje një brezi një njeri i këtij lloji, kur ka turp të kthejë kokën pas, thjeshtë për të parë vetveten!?

Ç' mund të kumtojë përpara një brezi në rritje një njeri që vendin e punës e ka të blerë? - një njeri që vjen



nga fusha e prostitucionit? - një njeri që politika i ka veshur 'mantelin e vet' pavarësisht se njihet si kriminel, vrasës, sekser, drogoman, që hidhet nga dega në degë me stil laraske, siç shprehej Krist Maloki në librin e tij "Oriental apo Oksidental" "Orientali shqiptar s'njeh turp a marre, a ma mirë: ai s'ka cipë që t'i nxihet...Idealet e orientalit shqiptar janë kolltuku e llokma; për t'i sigurua vetes këto të mira përdor ai çdo lloj mjete: bahet kur e do nevoja, edhe patriot e tradhtar, monarkist e bolshevik, përparimtar e reaksionar...e madje edhe shok i fortë me të tjerët. Porse në shpirtin e vet është kryekëput rrënimtar, asht destruktiv... dhe bashkohet me të tjerët si ata ujë që bëhen së bashku në pre...porse edhe si njata ujë që e shqyejnë shokun e vet, kur dobësohet apo plagoset udhës. Sepse orientali shqiptar i ka instinktet e ujkut monoambulant, t'ujkut tek..."

Të gjitha këto 'neveri njerëzore' i kemi të gjithëpushtetshme në të gjitha dikasteret tona. Të gjitha këto 'statura morale të pista' pengojnë qarkullimin normal të limfës së idealeve, për të cilat sot lufton e sakrifkohet një pjesë e inteligjencës shqiptare. Kaq të njohur janë për bëmat e tyre këto lloj njerëzish sa përpara se të vinë në krye te institucionit u vjen 'biografia shoqërore' e sterrosur! ...dhe jo më kot shprehem: Po, mor po, është ai që...!-Uh, po është ai që...! Ëhë, është ajo që...! Këta e këto janë njerëzit e

sëmure dhe të ligj të shoqërisë sonë.

Të jesh kriminel, trafikant, imoral-prostitutiv, sekser, bir e bij "Kristali", "Argenti", "Vitrine" etj, do të thotë të jesh i suksesshëm në kohën e sotme!!! (Po nuk e besuat, hidhni një sy të vëmendshëm rreth e rrotull vetvetes, pastaj do bindeni!).

Edhe, pse nuk duam ta pranojmë, prapëse prapë qëndron fakti i fortë, po të

idealet kanë mbetur të betonizuara që nga koha e aspiratës për bukë!!! Apo një shprehje tjetër po kaq shëmtarake sa e para: "Kujdes me letrat, ato t'i keni në rregull!" Kjo do të thotë, se 'burokracia' në këtë vend ia ka kaluar edhe kulmimit të romanit "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" të të madhit Agolli; tregon nivel papërgjegjshmërie në gjithë vijën hierarkike të institucionit; paaftësi fundore për të kontrolluar shkencërisht; formë fasadë që dominon e eklipson tërësisht përmbajtjen! Në këtë aspekt, Sami Frashri do të shprehej: "Shkalla e parë e marrëzisë është të kujtosh se je i mençur!" Siç e thashë edhe më lartë: Këta tipa, pa staturë morale, rrënjëzojnë aq fuqishëm, sa është mjaft e vështirë shfarosja e llojit të tyre, aq më tepër po u toleruan deri në atë pikë sa të formohen breza nën ndikimin e tyre. Këtë do ta quaja 'Fatalitet Kombëtar!'

Më kujtohet, kohë më parë, romani "Buddenbrookët" i Tomas Maniti. Ndonëse me një tematike krejt tjetër nga problematika që u përpoqa të ngre në këtë shkrim, gjej një kanotacion të përafërt problemor. Tek romani i Tomas Maniti, u desh të pritej tre-katër breza për të rënë dinastia pasurore e fisit të Buddenbrookeve. Dhe kjo rënie filloi me të ashtuquajturin "Rast klinik!", që do të thotë shfaqje e sëmundjes; shfarosje nga epidemitë ose mungesë e riprodhimit që çon në zhdukje të fisit, racës e më tej. Është, sa e trishtë aq edhe anormale, që ne të mendojmë për të shpëtuar nga këto 'qenie të neveritshme' nëpërmes pritjes së 'rastit klinik', por në fund të fundit një rrugë shpëtimi duhet për shoqërinë.

Nëse, këto 'statura imorale' vijonë si të tilla edhe në të ardhmen, atëherë pse 'jo' të mos shfaqet rasti klinik!?

Në ndërgjegjen time është i zhvlerësuar çdokush që i përkrah, i vlerëson, e aq më tepër i përkëdhel vetëm e vetëm për një interes ngushtarak të momentit. Në qoftë se përshtatemi me të keqen, atëherë jemi bashkëfajtorë me ata që e disponojnë, me ata që e bëjnë...thjeshtë: Jemi vetë ata!...kemi staturë e tyre, pavarësisht s'e nuk e dëshirojmë. Në rrugën e së drejtës nuk je kurrë i vetëm.

Është detyrë intelektuale të përsosësh shoqërinë, edhe në ato raste kur ka triumfuar 'e keqja'. Ja si shprehet Mino Maccori: "Kur triumfon e keqja, të jesh i mundur është fitore!". Unë, në këtë rast dua të jem i mundur!

LAZER KODRA

GJERGJ LEQEJZA, E GËZOSH “DEKORATËN E ARTË TË NDERIT PËR SHËRBIM NDAJ REPUBLIKËS SË AUSTRISË

Me 19 qershor 2019, në mjediset e Qendrës Rinore “Arka”, në Shkodër u organizua ceremonia e dekorimit të bashkëpunëtorit e mikut tonë , Gjergj Leqejza - konsull i Republikës së Austrisë për veriun e Shqipërisë, me qendër në Shkodër.

Ceremoninë e hapi Marjan Lukani, i cili pasi prezantoi ceremoninë, tha: “Në këtë ceremoni marrin pjesë plot personalitete të qytetit të Shkodrës, Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, prof. Dr. Adem Bektashi, prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Dr. Mimoza Priku, prof. Dr. Tomorr Osmani, prof. Dr. Tonin Gjuraj, prof. Ahmet Osja, skulptori Skënder Kraja, deputetja Senida Mesi, kompozitori Zef Çoba, kandidati për kryetar bashkie në Shkodër, Valdrin Pjetri, kryetari i këshillit të Bashkisë, Shkodër, Xhemal Bushati, mjeshtri Filip Guraziu, miq nga Tuzi, Gjak Dukaj dhe plot të tjerë, në veçanti Nëna e Gjergjit, Vitore Leqejza, me mbesën Jona. Të gjithë i falënderojmë për pjesëmarrjen dhe ju urojmë mirëseardhjen, në këtë ceremoni të veçantë për Shkodrën dhe Shqipërinë, në ceremoninë e dekorimit të zotit Gjergj Leqejza, nga Presidenti i Republikës së Austrisë, Shkëlqesia e Tij, Zoti Aleksandër Van DerBellen”.

Pastaj u dha himni i Republikës së Shqipërisë dhe himni i Republikës së Austrisë.

Përshëndetjet filluan, me zonzën Mimoza Priku, dekane e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, e cila në mes të tjerave,



Ambasadori dr. Johann Sattler duke përshëndetur dhe vendosur në gjoks dekoratën zotit Gjergj Leqejza

së bashkëpunimit midis Austrisë dhe Shqipërisë, nëpërmjet kontributit të tij në arsim (hapja e shkollës austriake në Shkodër), ekonomi dhe kulturë . Konsulli i Nderit i Republikës së Austrisë në Shkodër dekorohet me “**Dekoratën e Artë të Nderit për shërbim ndaj Republikës së Austrisë**”, me motivacion: “Për një veprimtari intensive, të pandërprerë dhe me përkushtim për forcimin e lidhjeve tradicionale midis Austrisë dhe Shqipërisë” dhe ja dorëzon zotit Gjergj.

Çaste shumë emocionuese, jo vetëm kur Ambasadori dr. Johann i vendos në

këto çaste emocionuese të zotit Gjergj, që po i dorëzohet dekorata më e lartë e republikës së Austrisë, i akorduar nga Presidenti i saj, Shkëlqesia e Tij, i Aleksandër Van DerBellen.

Ndjem dy herë mirë:

Së pari, se po dekorohet miku im, Gjergj Leqejza;

Së dyti, se po dekorohet bashkëpunëtor më i ngushtë në drejtimin e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, N/kryetari i saj, Gjergj Leqejza.

Prandaj, e falënderojmë grupin propozues, ambasadorin e republikës së Aus-

të kryer detyrën e për të ecur në rrjedhat e normalitetit. Në ato çaste kishim një bashkëpunim mjaft serioz e të përgjegjshëm. Pra, te Gjergji ishin mishëruar përgjegjësia, përkushtimi, qytetaria, intelektualizmi, bashkëpunimi, por dhe njerëzia, që të gjitha këto bashkë bënë të mundur të kryente me mjaft sukses detyrën e Prefektit.

Koha bëri punën e vet, që nga viti 2004 e në vijim, Gjergji të jetë pjesë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me një përkushtim të jashtëzakonshëm vullnetar.

Me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës, Gjergj Leqejzen e Luigj Milen, kryesia e Shoqatës i propozoi Këshillit të Qarkut Shkodër, për ti nderuar me titullin e lartë “**Nderi i Qarkut Shkodër**”, i cili e vlerësoi propozimin tonë . Ata të dy u nderuan dhe ju dorëzua ky titull i lartë , me datën 31 mars 2019, në një çast mjaft solem, në ceremoninë e paraqitjes së librit “Dukagjini IV”, klerikë të shquar të Dukagjinit, me autorë Prele Milani e Lazer Kodra, në mjedisin e sallës së “Kardinal Mikel Koliqi”.

E theksova këtë moment, se kur i kërkoja CV-në e plotë zotit Gjergj dhe e lexova me vëmendje të madhe, por dhe i çuditur, i thashë vetes: “Ky njeri dhe sikur dita të jetë jo 24 orë , por dyfishi i saj, nuk mund ti dali koha të merret me gjithë këto angazhime dhe me një përkushtim të jashtëzakonshëm!” Por, të gjitha këto detyrime i kryen vetëm ai, që është i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë, është intelektual, i formuar si njeri në shërbim



Nëna Vitore duke uruar të birin, Gjergjin

shprehu kënaqësinë e trupës Akademike për dekorimin e zotit Gjergj, për bashkëpunimin e ngushtë të konsullit me Universitetin “Luigj Gurakuqi” dhe besimin e vijimit të këtij bashkëpunimi;

Përshëndetjet vijuan me Ndue Sanaj, kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe më pas me mjeshtrin Filip Guraziu, i cili shprehu kënaqësinë e dekorimit të zotit Gjergj në emër të shoqatës së Përndjekurve Politik, dega Shkodër.

Pastaj e mori fjalën Ambasadori i Republikës së Austrisë, në Tiranë , dr. Johann Sattler, i cili pasi përshëndeti në emër të Presidentit të Republikës së Austrisë, tha: “Ndë r këto 15 vite, ai, Gjergji ka shkruar një tjetër kapitull të historisë

gjoks dekoratën, por në veçanti kur Nëna Vitore afrohet, i jep dorën Gjergjit dhe e përqafton birin e saj, duke i uruar marrjen e kësaj dekorate.

Urime miku ynë, Gjergj Leqejza!

Fjala e plotë për rshë ndetë se e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj

Të nderuar të pranishëm!

I nderuar shkëlqesi ambasador, dr. Johann Sattler!

Zonja e zotërinj!

E ndjejë veten të privilegjuar, ndjeje kënaqësi të veçantë , që marrë pjesë në



Dr. Johann duke i dorëzuar dekoratën zotit Gjergj Leqejza.

trisë, zoti Johann, por dhe zotin President, që vlerësoi propozimin për dekorimin e zotit Gjergj, me “**Dekoratën e Artë të Nderit për shërbim ndaj Republikës së Austrisë**”.

Me zotin Gjergj më takoj rasti të njëhem në vitin 2000, kur ai ishte në detyrën e rëndësishme të prefektit të Qarkut Shkodër dhe unë në detyrën e shefit të shtabit të Divizionit të Këmbësorisë, me qendër në qytetin e Shkodrës. U njohëm në momente mjaft të rënda për vendin, por në veçanti për Shkodrën, se sapo kishim dalë nga ngjarjet e tmerrshme të vitit 1997 dhe i ishim futur normalitetit, të cilat kërkonin përkushtim, ndjenjë n e përgjegjësisë qytetare dhe si pushtetar për

te të tjerave, komunikues, i thjeshtë , i dashur, gjithnjë për të zgjidhur problematika që mund të krijojnë sherre dhe gjithnjë për të gjetur rrugën e duhur për të ecur përpara.

Edhe njëherë falënderoj zotin Johann dhe shkëlqesinë tij, Aleksandër Van DerBellen, Presidentin e Republikës së Austrisë, për dekorimin zotit Gjergj Leqejza!

Zoti Gjergj, ne emrin tim personal, por dhe në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” të uroj: “E gëzosh dekoratën e lartë të Republikës së Austrisë, “Dekoratën e Artë të Nderit për shërbim ndaj Republikës së Austrisë”!

Ju faleminderit!

Redaksia

TOME MARVUKAJ, “ANËTAR NDERI I SHOQATËS SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT, MALËSISË SË MADHE”

Me datë n 22. 06. 2019, në sallë n e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Malësi Madhe”, u organizua ceremonia e dorëzimit të titullit “Anëtar Nderi i shoqatës së Shkrimtarët dhe Artistët, M. Madhe”, instrumentistit të shquar popullor, kantautorit dhe kompozitorit Tomë Prenkë Marvukaj, djalë i Shkrelit të vlerave kulturore dhe historike, aktualisht qytetarit, nënshtetas i Republikës së Italisë fqinje prej mbi 25 vitesh. Kush është Tomë Marvukaj në detajet e një jete artistike, plot vitalitet?

Ja disa nga stacionet e kësaj jete brilante: Kantautori i melodisë me çifteli, sikurse kompozitori i këngëve ”O nënë prit se erdha!”, interpretuar nga Arben Delaj; ”Për ty malësia ime”, interpretuar nga Petrit Gjina; ”Kush e nje prej jush Binakun?”, interpretim dhe autorësi e Tomë Marvukaj; ”Moj e mira në luginë të Shkrelit!”, teksti Anton Grishaj, interpretuar nga Nush Tuçaj, dhe qindëra melodi në festivale lokale dhe kombëtare, pa haruar pjesët humoristike dhe kontributet si drejtues artistik programesh në diasporë,

Kujtohet në Malësi, si një mrekulli më vete e një familjeje artistësh, fakti kur Prekë Zefi, babai i Tomës, këndonin së bashku me Drande Gjon Marvukaj, gruan e vet, deri para 10 vitesh që u nda nga jeta, këngën popullore, ”Maja krahu”.

Pas fjalës kryesore, që mbajti kryetari i shoqatës Kadri Ujkaj, i cili i dorëzoi edhe titullin “Anëtar Nderi i shoqatës”, fjala iu dha të nderuarit, Tomë Marvukaj, që përmes emocioneve dhe ndjeshmërisë maksimale vlerësoi aktin promovues, që i kushtoi kbashkesia ei artistëve dhe shkrimtarëve malësorë. Në vijim mbesa e artistit, Verarta Marvukaj i dorëzoi artistit, Tomë Marvukaj, një tufë me lule.

Vijuan me përshëndetje, gjithë respekt për artistin, kryebashkiaku Tonin Marinaj, zotërinjtë Ndue Sanaj, Ilmi Kurti, Fatmir Ulaj, Margarita Marvukaj, Gjokë Luli, sikur u bën edhe përshëndetje me dy interpretime instrumentale nga T. Marvukaj dhe kolegu i tij, Fatmir Ulaj.

Duke nderuar kontributin e artistëve malësorë, këtyre ambasadorëve shpirtërorë të trevës sonë, kësaj radhe u



aktualisht drejtor i grupit artistik ”Ura e Bashkimit”, në Legano të Milanos, e te tjera kontribute.

Ja gjerdani i artë i vlerave artistike të artistit Tomë Prenkë Marvukaj, që na mblodhi në këtë eveniment të nderuar pjesëmarrës.

Duke synuar te rrokim standartin promovues të dorëzimit të titullit të nderit u ftuan autoritete qeverisëse lokale, si kryetari i Bashkisë M. Madhe, Tonin Marinaj; n/kryetari S. Ndrecaj, nënprefekte Taze Lohja, botuesi i revistës “Fjala”, Gëzim Vuçaj, shkrimtarë dhe artistë malësorë si: Isuf Hebah, Syrja Smajlaj, Fadil Hasamujaj, Gëzim Vuçaj, Petrit Gjina, Fatmir Ulaj (te dy nga diaspora), Jonuz Delaj, Nikollë Buçi si dhe poetja Life Hasa, ish-përgjegjëse e kulturës në Zagorë (Shkrel), ku filloi debutimin e tij instrumentist i shquar Tomë Marvukaj i ri, Violeta Deda, këngëtare e njohur dhe bashkëudhëtare me artistin. Në promovimin e titullit të nderit kushtuar Tomë Marvukaj një grup më vete artistësh përbënte vetë familja Marvukaj, vëllezër dhe motra, këngëtarë dhe instrumentistë, filluar nga Tomë, Dedë, Fran, Margarita, Pranvera dhe kushërinjtë Marvukaj.

ndalem në vlerat konfirmuese, në dobi të identitetit tonë sa atij lokal, po aq kombëtar, tek njëri nga instrumentistët e shkëlqyer të kësaj treve, i nderuar mes miqve të tij artistë, si “Ndue Shyti i Malësisë së Madhe”, Tomë Marvukaj, anëtar i shoqatës”Shkrimtarët dhe Artistët, Malësi e Madhe”.

Tomë Prenkë Marvukaj lindi në fshatin Zagorë, M. Madhe, më 7 mars 1967, që për arsye të njohura biografie u mjaftua vetëm me arsimin e mesëm bujqësor, edhe pse dalloj si një talent i jashtëzakonshëm, si instrumentist, virtuozi i të cilit me çifteli i ka tejkaluar me kohë kufinj të Malësisë së Madhe, Shkodrës, por edhe të Shqipërisë. E ndoqa në jetën e festivaleve tona folklorike, instrumentale, në Malësi të Madhe apo në Shkodër dhe kudo nëpër Shqipëri, por po aq e njoha edhe në Italinë fqinje, ku prej mbi dy dekadash kontribuon si drejtues artistik i një grupi shumë elegant, i përbërë prej instrumentistësh malësorë, në rajonin e Lombardisë. Edhe pse, jo i ri në moshë, ai kushtrimon me tingullin e tij të shpirtit si mjeshtrë i instrumentit duke fituar nderimin dhe vëmendjen, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të autoriteteve komunare



të Vareses, ku aktualisht kontribuon. Me qindra melodi instrumentale, si kantautor dhe interpretues, melodi të luajtura me vëllezërit Lleshi, Buçi si dhe ato me instrumentistë popullor të kalibrit të Sali Mani ”Artist i merituar”, apo me Jonuz Delajn, Pretash Nilajt, Fadil Mustafën, vëllezërit Vukaj e të tjerë. nën drejtimin e mjeshtrit të këtij profili, profesor Robert Prendushit. Njëherësh para viteve 90’ Marvukaj do të debutojë suksesshëm në Fier, Shkodër, Pallatin e Kongreseve në kongresin e 6-të të kooperativave bujqësore, në Përmet, Sarandë e të tjera, gjithnjë në klimën e një konkurimi profesional, tejet të suksesshëm, me artistë nga më shquarit, të këtij profili. Suksesin më të madh Tomë Marvukaj do ta korrë në vitin 1988 në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, ku së bashku me grupin e

instrumentistëve, do të nderohen me titullin “Laureat i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës”.

Janë të gjithë këto argumente që motivuan shoqatën “Shkrimtarët dhe Artistët, Malësi e Madhe, të nderojnë artistin malësor, Tomë Prenkë Marvukaj me titullin ”Anëtar nderi i shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Malësisë së Madhe”, po aq frymëzuan tek ne, si institucion i vlerave estetike, vendimin e kësaj shoqate që t’i propozojë ditë më parë, suksesshëm, këshillit bashkiak të Bashkisë së Malësisë së Madhe, që z. Tomë Marvukaj, me motivacion: “Për përkushtimin e shkëlqyer dhe seriozitetin e arritjeve profesionale artistike, si instrumentist dhe kantautor, duke u bërë zëdhënësi autentik i shpirtit të malësorit, si djalë i kësaj treve, t’i jepet titulli ”Qytetar Nderi i Bashkisë Malësi e Madhe”.

Ky ishte djali i Malësisë së Madhe, artisti i kësaj treve, njëherazi edhe qytetari shembullor i Republikës së Italisë fqinje, Tomë Marvukaj, që na mblodhi në këtë eveniment kulturor sa personal, sa familjar, sa për ne si trevë e Malësisë së Madhe.

Në fund të veprimtarisë u organizua një koktej.

Mirënjohja jonë maksimale shkon edhe në adresë të mjekut shembullor, Doktor Seit Ymeri, që falë investimit të tij bashkëkohor, nga pikëpamja e komoditetit tejet elegant, që na ofroi në sallën promovuese, gjithçka funksionoi në përfeksion, duke e dëshmuar veten si mik i madh i shkrimtarëve dhe artistëve.

Kadri Ujkaj

NDAHET NGA JETA MJEKU SIMON FISTANI

Ditët e fundit u nda nga jeta, në moshën 79 vjeçare mjeku Simon Fistani.

Doktor Simoni u lind në vitin 1940 në qytetin Shkodër. Arsimin fillor dhe shtatëvjeçarë e kreu në qytetin e lindjes. Pas kësaj vijon në shkollën e mesme mjeksore në Tiranë. Bazuar në rezultatet e larta i del e drejta për të vijuar universitetin e Tiranës në degën e mjekësisë. Ka kryer specializimin në degën neorologji.

Më pas fillon punë në spitalin civil në Shkodër, si specialist për kokë dhe veshë.

Punoj me përkushtim të madh në shërbim të popullit kudo dhe kudo e kërkonte nevoja, gjatë gjithë jetës.

Në shërbim të thirrjes së kohës, del vullnetar për të punuar në zonat malore, konkretisht në Dukagjin. Atje punoj edhe si mjek dhe si drejtues i spitalit. Puna e tij, bashkë me kolegët mjekët dhe punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor ishte shembullore.

Ai u largue nga Dukagjini me shumë respekt nga të gjithë.

Dr. Simon Fistani do të kujtohet gjatë dhe me shumë respekt, për punën e tij të përkushtuar dhe marrëdhëniet e mira shoqërore.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe Redaksia e gazetës “Dukagjini” ngushllon fimeiljen dhe të afërmit e Dr Simon Fistanit.

Pushoftë në Paqe!

NDUE MICI



“PREKA I GJONIT” VJEN NË SHKODËR NGA SHKRIMTARI LEKE IMERAJ. PROMOVHET VEPRA QË SJELL NJË PERSONAZH REAL, FRYMËZUES PËR BREZAT.

“Preka i Gjonit” ka sjellë së bashku në bibliotekën “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës, shkrimtarë, intelektualë, lexues të rregullt, jo vetëm të këtij qyteti, por edhe nga Tirana, Prishtina, Tuzi, etj. “Unë...vetëm guxova” është nëntitulli i kësaj veprë që intrigon këdo për ta pasur veprën në dorë.

Autori i mirënjohur Lekë Imeraj, ka befasuar lexuesin kësaj radhe me përzgjedhjen e një personazhi nga jeta reale dhe zbulimin e një rrugëtimi sfilites që e vendos atë në përballje me sfidat, për të kuptuar çfarë e udhëheq njeriun me zemër të mirë në përballjen me vështirësitë e pamumërta.

Historia e Prekes, nga fshati Kllogjen të Dushmanit, në njësinë administrative të Temalit, vjen si një radiografi e një realiteti shumë pak të njohur ose ne rrezikun e fshirjes nga kujtesa e atyre pak që e dinë.

Nisja e jetës në një fshat ku paragjykohej gjinia që në lindje, kalvari i mundimeve, mbartja kudo, ku hidhte këmbën, e pjesës më të mirë të mendësisë nga vendlindja e tij, vijnë përmes detajeve të mrekullueshme dhe të besueshme, pa fryrje artificiale, për të krijuar figurën e heroit në veprë.

Në promovimin e librit, të pranishmit ngritën vija paralele mes opinioneve të studiuesve rreth veprës dhe personazhit të pranishëm në sallë. Pikat e takimit janë befasese, çka tregon analizën e hollësishme që autori Imeraj i ka bërë atij. Një përputhshmëri, e cila nis që tek qëndrimi i Prekës, butësia e tij, edhe pse me pamje vigani, si dhe heshtja dalluese e një njeriu punëtor.

Po përse një personazh i thjeshtë në dukje meriton një vëmendje të tillë, dhe një libër të posaçëm?

Asnjë bëmë e pazakontë nuk do ta rrisë kërkshërinë për ta lexuar veprën. Asnjë konflikt i hapur nuk do rrisë vëmendjen për të pritur rezultatin. Preka luftën e tij e ka me jetën. Përkujdesja ndaj 11 frymëve që lë në vendlindjen e tij, e vendos atë para përgjegjësisë morale të pa shkruara, duke u kthyer në shpëtimtarin e vetëm të një familje, e cila jetonte në skajet ekstreme të varfërisë. Një adoleshent, ende i pa rritur mirë, provon rrugëtimin e gjatë e të pasigurte të jetës pas viteve 1990. Depërton mes një terreni të vështirë në zonat kufitare drejt Greqisë, ku askush nuk të jepte garanci për jetën e ku prania e ndonjë kufome gjatë monopateve të kalte datën. I riu pranoi çdo vuajtje në heshtje, u vetmohu, i hoqi vetes çdo të drejtë për të gëzuar jetën. E gjitha kjo, në emër të asaj dashurie që ai ushqeu dhe ushqen ende për të afërmit e tij.

Pranimi i fatit, mos dorëzimi para asaj që quhej e pamundur, janë në dyluftim të përhershëm gjatë gjithë kalvarit të mundimeve.



Ajo që e bën veprën të përpilhet gjatë leximit është gërshetimi mjeshëtor që autori Lekë Imeraj i ka bërë faktit të ngjarjes me interpretimin psikologjik. Duke qenë se vepra do të lexohet edhe nga ato mosha që nuk e kanë njohur realitetin shqiptar para viteve 90, ka qene më se i



nevojshëm interpretimi i disa mendësive. Vepra nuk do të kuptohet nga të gjithë nëse ato nuk do të ishin shpjeguar aq këndshëm, aq qartë, dhe prezantuar me një stil letrar mjaft mirë të përpunuar nga autori Imeraj. Analiza, e cila e ruan masën e saj pa na shkëputur nga subjekti i veprës, krijon konceptime të drejtpërdrejta, të cilat udhëtojnë natyrshëm me stilin e të rrëfyerit. Vepra kurrsesi nuk merr përsipër të bëjë biografinë e një njeriu, por përpiket të sjellë një panoramë të një brezi të tërë, i cili bëri një luftë të ashpër për mbijetesë dhe që dëshmoi se familja shqiptare ka qenë një familje me rrënjë të forta, ku jo gjithmonë gjërat duhen interpretuar mbi bazën e patriarkalitetit. Në këto marrëdhënie para së gjithash kishte dashuri, sakrificë, ndihmë dhe përgjegjësi. Janë këto tipare që gjithnjë dhe më tepër po i zbehen shoqërisë shqiptare. Familja tek ne po e humbet bërthamën e

saj, dhe Preka i Gjonit është modeli pas së cilit duhet të frymëzohen prindërit dhe edukojnë fëmijët e tyre.

E parë në planin individual, çdokush nga ne e ka të nevojshme të njohë një histori suksesi, sidomos në rastet kur çdo gjë nisët nga zero. Preka u nis në kulmin e varfërisë nga Kllogjeni, emigroi në Greqi, Itali, Angli. Bëri punë të rënda, mbajti familjen. Historia nuk përfundon këtu. Ai rikthehet në atdhe dhe me ato pak kurrsime që kishte grumbulluar nisi aktivitetin e tij privat. Sot Prek Gjoni ka në pronësinë e tij 4 markete në Shkodër dhe 2 në Lezhë. Janë 60 punëtorë që janë punësuar pranë bizneseve të tij. Preka vijon të bëjë jetën plot sakrificë. Kësaj radhe sistemi i të punuarit fort, është pjesë e natyrës dhe psikologjisë së tij. Zgjohej në orën 3.30 të mëngjesit. Ai vetë bën shpërndarjen e mallit në markete, kujdeset për çdo gjë. Nuk është aspak tipi i zyrës. Fizionomia e tij dëshmon një njeri që punon fort, me duart plot kallo. Preka qëndron para të pranishmëve në sallën e bibliotekës si i zënë në faj. Ai është njeri modest dhe e mbulojnë djersët për çdo fjale të mirë që thuhet rreth tij. Me gjysmë zëri falënderon këdo. Ai mendon se jeta e tij nuk është më e mirë se e të tjerëve dhe ai vetë nuk është më i ditur së të tjerët. Asnjë lavdërim apo mburrje nuk dëgjohej nga goja e tij. Preka bëhet për të pranishmit aty, model i njeriu jo vetëm punëtor por edhe me zemër të mirë. E ndoshta kjo është një arsye e fortë për ta njohur atë përmes veprës, shkruar nga autori Lekë Imeraj dhe gjetur dritë shprese në realitetin e zyrtë, në të cilin jetojmë.

“Duke udhëtuar në pasazhet dhe labirintet e tekstit, bindemi deri në mahnitje për talentin e shkrimtarit dhe aftësinë e madhe të pasqyrit të gjendjeve shpirtërore e të peripecive të jetës së heroit. Tashmë libri merr trajtën e përgjithësisht, bëhet vepër e vërtete letrare”, - u shpreh profesori i nderuar dhe kryetari i shoqatës së shkrimtarëve Shkodër, Zija Vukaj. Akoma më emocionuese ishte fjala e dramaturgut të mirënjohur shkodran dhe Mjeshtrit të Madh Fadil Kraja, për forcën frymëzuese që të jep ky personazh dhe që qëndron në një përballje të ashpër me atë që na ofron realiteti shqiptar çdo ditë. Psikologjia e mirënjohur Suela Ndoja, pas leximit që i kishte bërë veprës, zbuloi para të pranishmëve botëkuptimin e heroit dhe vërtetësinë e tij, sjelle me mjeshëteri nga Imeraj. Aktorja e mrekullueshme Merita Smaja interpretoi fragmente emocionuese nga vepra duke i bërë të mbanin frymën në sallë nga kureshtja. Një përshëndetje tepër e ngrohtë përgëzimi ndaj autorit Imeraj, u bë dhe nga prof. dr. Teuta Bicaj e ardhur nga Prishtina. Po ashtu prof. dr. Mark Palnikaj solli në

vëmendjen e audiencës kontributin ndër vite të autorit të veprës, Imeraj, duke vënë theksin jo aq të prodhimtaria, sesa tek roli i Imeraj në emancipimin e shoqërisë shqiptare.

Por le të ndalemi pak tek ky i fundit. Kush është Imeraj?

Lekë Imeraj është autori i 25 librave të botuara deri tani. Një shkrimtar mjaft produktiv, që ka krijuar një reputacion mjaft të mirë në Shkodër dhe jo vetëm. Në veprat e tij do e gjejmë herë si shkrimtar dhe herë si publicist apo si përkthyes i gjuhës gjermane. Prej 2 dekadash jeton në Gjermani dhe kjo i ka dhënë dorë të krijojë një mendësi evropiane në analizimin e fenomeneve shoqërore. Leximet e shumta dhe shkrimet e kanë bërë tashmë atë një sociolog të shkëlqyer. Në rrethet letrare dhe në biseda me intelektualë shquhet për gjykimet me mendje të ftohtë të situatave nga më të thjeshtat e deri tek ato që lidhen me fatet e kombit. Drama “Terror” përkthyer nga Imeraj korri një sukses tepër të madh në Tiranë dhe u luajt nga aktoret më të mirë shqiptarë. Por cilat janë disa nga veprat e tij më të njohura? Tematika e tyre ndahet në rrafshet: psikologji, filozofi dhe sociologji. Me veprën e 25-të “Preka i Gjonit” ai lëvroi edhe letërsinë artistike me mjaft sukses. Imeraj u ka kushtuar vepra fëmijëve dhe adoleshentëve si: “Tomë mëson, luan dhe vizaton”, “Ne nuk jemi më fëmijë”, “Tragedia seksuale e Gjermanisë”, etj. Por një mbresë të pashlyeshme tek lexuesit shqiptarë ai ka lënë me veprat dedikuar figurës së femrës, duke bërë analizën e detajuar të gjithë psikologjisë së saj dhe dukë e vënë atë në përballje me burrat, me qëllim që të dy palët ta njohin njeri-tjetrin para se të paragjykohej. Vepra që janë mirëpritur në këtë fushë janë: “Të fshehtat e gruas”, “Viktima të pushtetit të verbër”, “Unë studente dhe prostitutë” (përkthim), etj. Lekë Imeraj konsiderohet ndër të paktët autorë në Shqipëri që ka marrë përsipër të trajtojë me kurajo tema me rëndësi botërore, nisur nga aktualiteti dhe shqetësimi në mbarë opinionin ndërkombëtar që vërtitet rreth tyre, si psh: “Nën hijen e diktatorit”, “Leila akuzon”, “Xhihadistët e rijnë”, “Rrymat dhe lëvizjet fashiste brenda botës islame”, (përkthime) etj.

Të gjitha botimet e Imeraj priten me padurim nga lexuesit. Para 15 viteve ai theu tabutë në mendësinë shqiptare, gjë që jo pak e ka vendosur atë në pozita kontestimesh me pseudo-intelektualë. Është një luftë që Imeraj vazhdon ta bëjë edhe sot dhe lehtësisht kuptohet se asgjë nuk do ta ndalte në rrugën e zgjedhur, për të kontribuar në zhvillimin e Shqipërisë e sidomos shqiptarëve, një zhvillim që para së gjithash duhet të nisë tek formimi i brendshëm shpirtëror, mendësia e përparuar dhe krijimi i vizionit të qartë për të ardhmen.

Përgatiti, **Kozeta Bruçi**

DHURO DASHURI E PËRKUJDESJE

Është krijuar traditë që çdo fund viti, në shkollën 9 vjeçare Bardhaj të zhvillohen veprimtari të ndryshme me karakter edukativ, të cilat i shërbejnë edhe procesit mësimor. I tillë ishte edhe ai i 30 majit 2019, me moton: **”Dhuro dashuri e përkujdesje”**, një veprimtari sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të familjes.

Qëllimi ishte që të gjithë së bashku të luftojmë për një familje të fuqizuar, pa fenomene negative dhe plot dashuri, siguri e përkujdesje. Që në kontaktin e parë me këtë shkollë të lë në mbresa shumë pozitive, për paraqitjen e saj, për higjienën e pastërtinë shembullore, një gjelbërim për tu pasur zili, me një figuracion që pasqyron vetëm arritje, pra, një mjedis që të bën të arrish në konkluzionin se në këtë shkollë punohet dhe edukohet.

Në këtë veprimtari morën pjesë: mësues e ish-mësues të kësaj shkolle, nxënës e prind, drejtues të shkollave të njësisë administrative Rrethina, përfaqësues shoqatash dhe institucionesh që i kanë dhënë ndihmesën e tyre kësaj shkolle, përfaqësues nga DAR Shkodër, kryetari i shoqatës Atdhetare Dukagjini z Ndue Sanaj si dhe drejtues të pushtetit vendor si: kryetarja e bashkisë Shkodër znj Voltana Ademi, administrator i njësisë Rrethina z Vlash Pjetri dhe kryetari i fshatit z Fran Radohina.

Fjalën e rastit e mbajti zv drejtori i kësaj shkolle z Lekë Pjetri, fjalëpakë e punë shumë, i cili mbasi falënderoi pjesëmarrësit, bëri një ekspozitë për arritjet e kësaj shkolle në të gjitha fushat, për frymën mobilizuese e bashkëpunuese që kanë bërë që rezultatet e arritura kanë pas progres nga viti në vit.

Për këtë veprimtari kishin marrë një temë shumë interesante, atë të rolit të familjes në shoqëri si qelizë e saj, sepse jemi të ndërgjegjshëm se, ne kohën ku jetojmë edhe ajo ka pësua një “krisje” duke mos e luajtur tamam rolin që ajo ka, sidomos në drejtim të edukimit të prestatëve të saj, në papajtueshmëri me shumë dukuri negative që më përpara nuk i ka pasur. Gjerë e gjatë për këtë temë foli psikologu



i shkollës Arvjo Fishta, i cili tregoi për punën e bërë në këtë drejtim, si duhet të jetë familja, roli i saj i pazëvendësueshëm në edukimin e brezit të ri. Ai dha mesazhe se në çfarë drejtimesh duhet të punohet në mënyrë që familja të ngrihet në rolin e saj të duhur. Biseda e psikologut u shoqërua me një monitor.

Nga drejtorja e shkollës u dhanë disa mirënjohje: shoqatës E orld Vision për pajisjen me bazë materiale dhe mundësimin e veprimtarive të ndryshme; shkollës

Austriake “Peter Mahringer”, për pajisjet e sallës së informatikës dhe zhvillimin falas të kursit të gjermanishtes dhe Etërit Orionin Bardhaj, për këndin sportive dhe zhvillimin e mësimin pas-shkollor.

Përfaqësuesja e shoqatës, duke marrë certifikatën e mirënjohjes tha, se ne ndihmojmë vetëm ato shkolla që bindemi se aty punohet. Një e tillë është shkolla 9 vjeçare Bardhaj dhe ndihma jonë nuk do të mungojë as në të ardhmen.

Ovacione ngjalli përshëndetja e kryetares së bashkisë Shkodër z Voltana Ademi, e cila falënderoi kolektivin e kësaj shkolle për punën e bërë, në mënyrë të veçantë drejtoreshën e shkollës zj. Terezë Brigja, e cila me aftësitë e saj menaxhuese e drejtuese, me frymën e saj të bashkëpunimit, ja ka ndërrua faqen kësaj shkolle ku rezultatet kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Ajo u angazhua se as në të ardhmen nuk do të mungojë ndihmesa e bashkisë Shkodër për këtë shkollë.

Kjo veprimtari nxori në pah edhe punën e mirë që bëhet për zbulimin dhe evidentimin e talenteve të reja si në pikturë, këngë, recitime etj. Këtë e tregoi ekspozita e pikturës në përshtatje me temën e veprimtarisë dhe koncerti që u dha për të pranishmit nga grupi artistik i shkollës, me një repertor shumë të pasur me këngë, valle e recitime, të interpretuar cilësisht nga nxënësit e shkollës, të drejtuar me profesionalizëm nga mësuesi i muzikës i kësaj shkolle Arben Jubani dhe mësuesja e letërsisë Mira Pjetri.

Mbresëlënës ishte interpretimi i nxënësës Mirela Brushtulli me zërin e saj brilant, e cila ka fituar çmime edhe në veprimtaritë lokale në bazë qarku. Do të donim të dëgjonim më shumë këngë burimorë.

Drejtoresha e shkollës zj. Terezë Brigja (korrekte e vitale në punë, e vendosur për t'i çuar punët deri në fund, e papajtueshme ndaj të metave e dobësive dhe insistuese për eliminimin e tyre), përshëndeti të pranishmit, falënderoi në radhë të parë kolektivin e mësuesve e në mënyrë të veçantë dy zëvendësit e saj Lekë Pjetri e Roza Toka, për frymën bashkëpunuese dhe gatishmërinë për kryerjen e çdo detyre që ju ngarkohet. Ajo falënderoi edhe pushtetin vendor, shoqatat dhe institucionet të cilat e kanë ndihmuar në sjelljen e shkollës në këtë gjendje model që është sot.

Në shkollën e Bardhajve kanë çfarë të mësojnë shkollat e tjera, për mënyrën se si punohet për frymën e kolektivitetit, për ndërgjegjen në punë, për bashkëpunimin me bashkësinë e prindërve dhe me të gjithë ata që kanë mundësi me e dhënë ndikuesën e tyre.

Në këtë shkollë janë në harmoni puna mësimore me atë edukative. Kanë ardhur gjithnjë duke u pakësuar sjelljet dhe veprimet që nuk janë në përputhje me moralin tonë dhe që bien ndesh me vërtetë e virtytet më të mira që një malësor i qytetëruar duhet të kenë.

Çelësi i sukseseve në këtë shkollë është vënia në efikence të plotë të marrëdhënieve prind - mësues - nxënës - pushtet vendor - institucione të tjera ndihmëtare.

Arritjet e deri tanishme përbëjnë një bazë të shëndosh për suksese akoma më të larta në vitet e ardhshme mësimore.

Mbas përfundimit të kësaj veprimtarie shumë mbresëlënëse dhe efikase, për të pranishmit u shtrua një koktej shumë cilësor, sponsorizuar nga shoqata World Vision.

Prele SHYTANI,
Shkodër, qershor 2019



AGUSTIN ARAMADHI, MODELI I QËNDRIMTARIT PËRBALLE VËSHTIRËSIVE

Shoqëria jone ka nevojë për individ që janë model në jetën tonë të përditshme, që transmetojnë pozitivitet e mirësi, janë aktiv dhe japin shpresë, tregojnë rrugën përmes shembullit të tyre, si mund të përballohen vështirësitë, hallet dhe problemet e jetës, duke parë vetëm përpara.

Njerëz të tillë ka kudo, në çdo mjedis, në fshat e qytet. Por një i veçantë, një luftëtar këmbëngulës, që e do jetën, sido që të vijë është i riu Agustin Kol Aramadhi. Komuniteti jonë dukagjinasi, përmes gazetës tonë, por edhe më gjerë duhet të njihet me këtë model qendrestari. Për këtë menduam të shkruajmë për atë çfarë dëgjuam nga goja e tij.

Të shoh shpesh rrugëve të Tiranës, i kujdesshëm në trafik, pranë shkollave dhe institucioneve të ndryshme të rrethuar nga njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme, aktiv, sfidant, model i një njeriu që e do jetën dhe lufton për ta gëzuar me çdo kusht.

Agustin si ka qënë në rruga jote?

E kam të pamundur t'i përgjigjem kësaj pyetje në mënyrë të shkurtër, pa treguar një pjesë të mirë të historisë sime. Unë kam lindur në Tiranë në vitin 1996, një periudhë goxha e vështirë për çdokënd në Shqipëri, por akoma më e vështirë u bë për familjen time kur fill pas lindjes, u diagnostikova me sëmundjen e Poliomelitit, sëmundje e cila me dha paralizë të pjesshme në dorën e majtë, dhe paralizë të plotë në këmbën e djathtë duke më ndaluar kështu mundësinë për të ecur, përjetësisht.

Që në vogëli, familjarët e mi janë munduar që të gjejnë një zgjidhje të mundshme të problemit tim, një kurë ndoshta. Ndërkohë që vitet kalonin, situata ime shëndetësore përkeqësohej, pasi poliomieli kishte edhe efekte anësore përveç paralizës, një nga këto efekte ishte deformimi i shtyllës kurrizore, gjë e cila ishte kërcënuese edhe për jetën. Për të parandaluar me të keqen, prindërit e mi kanë shkuar në shumë institucione shëndetësore për të kërkuar trajtimin e duhur për të parandaluar përkeqësimin e situatës time. Në Shqipëri kam kryer 4 ndërhyrje kirurgjikale, për të zvogëluar sadopak pasojat e sëmundjes. Ndërhyrjen e parë e kam kryer që në moshën 6 vjeçare dhe operacionin e fundit në Shqipëri e kam kryer në moshën 9 vjeçare.

Pas kësaj, metodat dhe kapacitetet e spitaleve këtu, nuk ishin të mjaftueshme për të kryer ndërhyrje të



tjera të domosdoshme. Që në moshë të vogël prindërit e mi ishin munduar shumë herë të krijonin mundësinë që unë të dilja jashtë shteti për një trajtim më të specializuar. Por pas përfundimit të operacioneve këtu, u rekomandua nga mjekët që ndërhyrjet e tjera është

e pamundur të kryhen në Shqipëri apo edhe në Evropë, kështu që Amerika ishte e vetmja shpresë.

Pas shumë mundimeve dhe përpjekjeve për të gjetur lidhjet e duhura me njerëzit e duhur, u bë e mundur që të shkoj në SHBA në vitin 2011 në moshën 15 vjeçare duke filluar kështu maratonën 6 mujore të 5 operacioneve të tjera. Operacioni më i shkurtër për aspektin kohor ka që në 4 orë, dhe ai më i gjati e më i vështiri ka qënë 16 orë. Me anë të këtyre operacioneve u bë e mundur që deformimi i shtyllës kurrizore të rregullohet, që më mundëson tashmë të qëndroj drejt pa tkurrje të shpinës. Shkenca akoma nuk ka gjetur mënyrën e duhur për të larguar paralizën nga pjesë të trupit, kështu që fatkeqësisht, me duhet të pres në karrige me rrota deri sa kjo gjë të bëhet e mundur.

Këmbëngulja jote, lufta dhe përpjekja jote prej një heroi, deri ku ke arritur dhe çfarë objektivash i keni vënë vetes për të ardhmen?

Krahas sfidave shëndetësore, sfida të madhe kam pasur edhe për të marrë pjesë në sistemet arsimore si bashkë-

moshtarë t e mi. Arsyet kryesore që e pengonin kë të gjë ishin infrastruktura dhe anashkalimi i përgjegjësisë nga stafi i shkollave. Pasi në cilëndo shkollë që prindërit interesoheshin që unë të regjistrohem, pengesa e parë ishte infrastruktura që e bënte të pamundur që një fëmijë, përdorues i karrigës me rrota të merrte pjesë në mësim. Por edhe kur ndoshta në ndonjë shkollë të caktuar infrastruktura nuk përbente problem, stafi i shkollës e kishte të vështirë të merrte në institucion një fëmijë me aftësi ndryshe. Problemi u zgjidh vetëm kur unë isha në moshën 12 vjeçare, në këtë kohtë me anë të ndërhyrjes së prindërve, u bë e mundur që unë zhvilloj një test vlerësues nga drejtoria arsimore, Tiranë, rezultatet e të cilit treguan që isha i aftë që në atë moshë, të regjistrohem në klasën e pestë, dhe kjo e mundur vetëm falë prindërve të mi, që ishin munduar me çdo kusht gjatë viteve që unë të arsimohem në kushte shtëpie. Normalisht, të ulesh për herë të parë në bankat e shkollës në klasën e 5-të është e vështirë, e sidomos në rastin



VAJZAT SI "SHOTA"



Klodjana Serraj

Të gjithë e njohim Shotën, një heroinë me veshje mashkullore që luftoi për shumë vite për çlirim dhe bashkim të trojeve Shqiptare, e që gjithsesi mbetet femër, nëse kthehemi pas në kohe kemi edhe mbretëreshën Teutë ku perandoria Ilire në sundimin e saj ishte më e fortë. Ato janë simbol të heroinave por edhe Shotat e Teutat e ditëve të sotme nuk ndryshon shumë nga ato, por ne e kemi zbehur pak rëndësinë dhe vlerat që ato kanë dhe statistikat për keqtrajtimin e femrave në Shqipëri janë të frikshme kur në të vërtetë ato janë vendimmarrëset më të rëndësishme në familje ku është edhe ajka e zemra e shoqërisë, një femër mund ti bëjë të gjitha, mund të punojë, të kujdeset për fëmijët dhe për shtëpinë, dhe ky nuk është një artikull feminist por thjesht për të ndërgjegjësuar femrën për forcën që ka sepse siç duket ajo është e kënaqur në me pozicionin që ka në shoqëri, ku të gjithë e dimë se për të njëjtin pozicion pune femrat paguhen më pak. E ndërsa ne flasim akoma për të drejta në ditët e fundit në takim e G7, 7 shtetet më të fuqishme diskutuan që në Japoni të vishen apo të mos vishen taka në punë sepse ishte një formë detyrimi edhe ky peticion u firmos nga më shumë se 19 000 persona në ëeb (edhe pse për herë të parë këpucët me taka janë veshur nga meshkujt diku në vitet 1600), ne jemi shumë larg akoma por kemi bërë hapa të mië në postet drejtuese ku vitet e fundit shikojmë

më shumë femra në poste drejtuese dhe administrative.

Rëndësinë që ka femra në shoqëri na ka treguar edhe historia ku meshkujt me të suksesshme në botë dhe ndër vite e kanë sepse kanë pasur një krah të fortë mbështetës një femër, përmendim këtu ish presidentin një nga më të suksesshmit Barack Obama i cili e ka përmendur shpesh së gjithë forca dhe mbështetja ka ardhur nga bashkëshortja e tij, Bill Gates një nga njerëzit më të pasur në botë e pohon se forca më e madhe vjen nga Melinda bashkëshortja e tij, por edhe veprat me të mëdha të artit nga Shekspiri nga Einstein e pohojnë se suksesin më të madh e kanë si rezultat i pranisë së bashkëshortes së tyre, por edhe Napoleoni Bonaparti ky sundimtar i madh në letrat e fundit që ka shkruar nga burgu shpre-

het se rrënimi erdhi pikërisht pas divorcit që pati me bashkëshorten e tij. Në Shqipëri nuk di akoma të këtë pranuar dikush përveç Mbretit Agron, bashkëshortit të Teutës dhe Azem Galices bashkëshortit të Shotës se forca dhe fuqia e bashkëshortes është sukses, ndoshta është akoma shumë krenari por besoj e dinë në nënvetëdijen e tyre, prandaj ka dalë edhe proverbi se pas çdo mashkulli të suksesshëm është një femër.

Kjo tërheqje vëmendje vjen duke pasur si pikë synimi edhe misioni i ri i shoqatës sepse edhe aty një pjesë e mirë drejtues e stafit është femra por le të jetë edhe një thirrje për vajzat e Dukagjinit të ngrihen si shota për diçka që e pëlqejnë, për të realizuar ëndrrat e tyre të besojnë fort në to edhe të punojnë për ti realizuar, të jenë të zonjat e vetes duka ruajtur gjithmonë vlerat që na karakterizojnë të jemi edhe ne si vajzat evropiane, të marrim me shumë pjesë në veprimtaritë që zhvillojnë shoqata por edhe në qytet, të jenë më aktive në shprehjen e mendimeve, të jenë më aktive në procesin e vendimmarrjes të

interesave të përbashkëta sepse e dimë se kemi bekimin më të madh që ka një qenie njerëzore japim jetë. E një nga shembujt më të mirë në këtë drejtim është Zina Franja një nga femrat me të forta që u përfshi që në moshën 15 vjeçare në luftën nacional-çlirimtare, luftoi fort përkrahë burrave si të qe një mes tyre ku postet që ajo ka pasur për një emancipim shoqëror e kanë ngritur atë por edhe figurën e femrën dhe forcën e saj në shoqëri.

Femrat kanë bekimin të jenë nëna edhe në janë ato të parat që na edukojnë, kështu që një nënë e emancipuar do të rriste një shoqëri më të mirë, një shoqëri të vlefshme të anë ve tona për çdo brez që do vijë.

Le të jetë gjithashtu edhe një tërheqje vëmendje për të gjithë prindërit e veçanti por për të gjithë në përgjithësi, shkolloni vajzat, të jenë të zonjat e vetes nesër, sepse kur dinë qartë dhe saktë çfarë duam, jemi një shoqëri evropiane e zhvilluar, një shoqëri më e bashkuar me vlera të shtuara për të gjithë brezat që do vinë.



tim, që përveç shoqërisë pranë shtëpisë, ishte hera e parë që integrohesha në shoqëri të tjera. Drejtorja e arsimit bëri të mundur edhe gjetjen e shkollës së përshtatshme për nevojat e mija, që siguroi vazhdimin e studimeve në mënyrë të rregullt, duke mbajtur gjithmonë rezultate mbi mesataren, të larta.

Tanimë jam në vitin e tretë të shkollës së lartë pranë fakultetit të shkencave sociale, në degën e Shkencave politike.

Krahas studimeve, kam arritur që të punoj pranë institucioneve të ndryshme të sektorit publik dhe privat. Aktualisht punoj me kohë të pjesshme pranë kompanisë Vodafone pranë departamentit të burimeve njerëzore, si rekrutues, pozicion i cili me jep mundësinë të njoh njerëz të ndryshëm, dhe pse jo ti ndihmoj ata për

tu punësuar pranë kompanisë. Puna e dytë që unë bëj, është në sektorin publik, përkatësisht në Bashkinë Tiranë, ku jam këshillues për shqyrtimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që prekin Personat me Aftësi të Kufizuara në kryeqytet.

Normalisht e ardhmja është e paparashikueshme, por është e mundur që të krijosh objektiva që mbase mund të realizohen. Unë kam si qëllim kryesor përfundimin e studimeve Master, me shumë mundësi, në një nga Universitetet më në zë të SHBA-së. Pas kësaj, kam si qëllim karrierën politike këtu, ku me shpresën për të sjellë ndryshim, një ndryshim që i duhet kaq shumë vendit tonë.

Çfarë u këshilloj të rinjve të sotëm, moshatarëve të tu?

Ka shume të rinj, shokë të mi, të cilët punojnë fort për të jetuar një jetë

të ndershme dhe të suksesshme. Por fatkeqësisht, ka edhe nga ata të rinj që nuk e ndjekin si duhet rrugën e jetës, dhe për ta këshilla ime është farë e thjeshtë dhe e kuptueshme; Nëse për mua ka që në pengesë situata shëndetësore dhe goma e karrocës, që ka hasur në çdo prag, në çdo shkallë, dhe në çdo rrugë ku unë jam mundur të kaloj, por prapë se prapë ja kam dalë dhe kam ardhur këtu ku jam sot, cila qenka ajo pengesë aq e madhe për ju që ju ndaloni së bëri diçka të mirë për veten tuaj? Çfarë ju pengon që të vazhdoni shkollën? Çfarë ju pengon që të zini një vend pune që të ndihmoni sadopak familjen tuaj ose veten? Cilado qoftë ajo pengesë, jam shumë i sigurt që nuk është pengesë më e madhe se sa ka qënë goma e karrocës time për mua. Tejkaloj gjërat që ju pengojnë, cilado qofshin ato. Ngrihuni

nga kafja e përditshme që nuk ju sjell asnjë të mirë veçse ju ha orët e ditës, largohuni nga drogat dhe substancat e dëmshme që nuk ju sjellin asnjë të mirë veçse ju hanë vitet e jetës, dilni dhe kërkoni punë, dilni e shkoni në shkollë, arsimohuni që të bëheni dikush, nëse nuk ju intereson juve, mendoni për brezat që vijnë pas jush, çfarë do thonë ata për ju? Njeriu ka kapacitet të jashtëzakonshëm, mjafton vullneti dhe dëshira e mirë për të bërë gjëra të jashtëzakonshme.

Agustin, duke të falënderuar për gatishmërinë që treguat për të na treguar për rrugën tënde vështirësitë që keni kaluar, mesazhin që përcolle për të rinjtë e sotëm, të urojmë shëndet e suksese në rrugën tënde, kudo e në çdo drejtim.

Bashkëbiseduesi Zef BARI

“TË RUAJMË IDENTITETIN KOMBËTAR, GJUHËN TONË”



Nga Alfred Papuçiu, Zvicër

Një miku im i mirë zviceran kur bisedonim një ditë më tha: “On n’est grand homme qu’à la condition d’être homme d’abord”. Po e perifrashoj në shqip “Njeri i madh është ai që në radhë të parë është njeri”. Këtë mendova kur mora një mesazh të ngrohtë prej zonjës fisnike dhe tepër modeste, Nexhmije Mehmetaj, ku ndër të tjera më theksonte: “Përshëndetje, i nderuar z. Alfred. Mora me kënaqësi shkrimin kushtuar profesorit Assal, që më dërguat për ta lexuar. Ai na afron të dhëna të reja dhe të panjohura për një njeri të madh. Ju falenderoj! Edhe shkrimi për pedagogun Pestaloci i shkëlqyer, paralelizmi i përkryer dhe stili aq elegant. Urime! Artikullin për prof Basil Shader është i përkryer”.

E falenderova zonjën Mehmetaj për fjalët e ngrohta. E kam shprehur që I dërgoj herë pas here shkrime për figura të shquara që merren me gjuhën apo edukimin për të dhënë një mendim. Desha të theksoj, në këtë shkrim, nisur nga fjalët e zonjës Nexhmije, siç e kam ngritur edhe herë tjetër, punën që duhet bërë me Diasporën shqiptare disa milionëshe jashtë shtetit.

Zviceranët jashtë janë sot mbi 700 mijë vetë, nga të cilët tre të katërtët kanë dyshetësinë. Për të mbrojtur interesat e tyre, Organizata e Zviceranëve Jashtë shtetit, mban çdo vit Kongresin e saj vjetor, në Lucernë të Zvicrës. Ajo egziston qysh nga viti 1916 dhe njihet nga autoritetet si zëdhënëse e zviceranëve jashtë qysh nga viti 1966. Zakonisht e quajtur si “Zvicra e Pestë”, ajo përfaqëson pothuajse një të dhjetën e popullsisë të të gjithë vendit. Zviceranët jashtë votojnë me korrespondencë qysh nga viti 1992. Sipas Organizatës së Zviceranëve Jashtë shtetit, zviceranët që jetojnë jashtë vendit të tyre, janë si ndërmjetës midis Zvicrës dhe kombit ku janë vendosur. Me rrjetet që ata disponojnë, janë në pozicion të mirë për të bërë që të tjerët të kuptojnë Zvicrën, politikën dhe vlerat e saj.

A do të arrijë dhe Kombi ynë ndonjëherë që t’i tërheqë rreth vetes nëpërmjet përfaqësive diplomatike jashtë, shtetasit e vet? Dhe jo vetëm, në Festën Kombëtare, edhe ato me pikatore, jo çdo vit, ku shumë prej tyre mbeten jashtë liste,

pasi në to prioriteti u jepet diplomatëve të huaj... Si rastësisht, lidhur me këtë temë, kisha marrë disa vite më parë, nga mësuesja Nexhmije Mehmetaj e Courgenay në Zhyra (Jura) letrën e përshëndetjes të gazetarit Peggy Frey, i cili realizoi artikullin tek gazeta “Le Nouvelliste” “Nekemi dy vende, dy histori”. Dhe ai vazhdon: “Në tavolinën e një familje shqiptare nga Kosova ngërthejnë kujtimet. Një mënyrë për të zbuluar traditat e këtyre të larguarve nga vendi i tyre dhe të vendosur në Zhyra. Në Zvicër, ata janë 200 mijë, bashkësia e dytë e huaj e vendit... E apasionuar për letërsi dhe gjuhësi, Nexhmija, nëna, jep mësim gjuhën shqipe fëmijëve të bashkësisë. Neziri, babai, ka punuar në ndërtimin e tuneleve të Transzhyrasë. Liburni, djali, fillon studimet për drejtësi në Universitetin e Friburgut”. Dhe dje ndër të tjera, zonja Nexhmije më njoftonte se Liburni është tashmë avokat në Gjenevë. Pra një kuadër tjetër me vlerë nga Kosova, në Zvicër. Mësuesen e shquar dhe atdhetare, veprimtaren e palodhur të gjuhës shqipe, Nexhmije Mehmetaj e kam takuar për herë të parë në veprimtarinë e organizuar disa vite më parë në Nëshatel, për botimin e librit të Akademik Bedri Dedja “Presidenti i planetit të kuq”, Planetit Mars, ku merrte pjesë dhe mikja jonë e përbashkët, “Nderi i Kombit”, e paharruara Vaçe Zela. Ishte takimi i parafundit i “Divas shqiptare” me bashkëkombasit, para atij organizuar në Gjenevë, nga Universiteti Popullor Shqiptar, ku merrte pjesë dhe zëri i artë nga Kosova, Nexhmije Pagarusha. Ishte i pranishëm dhe bashkëshorti i Vaçes, Pjetri dhe e bija Irma Rodiqi. Kujtime të paharruara për diasporën shqiptare në Zvicër që do mbeten të pashlyera në mendjet e tyre. Le të kthehemi tek tema jonë. Kemi vijuar të komunikojmë herë pas here dhe Nexhmija më ka dërguar edhe mendime të vyera për shkollën shqipe në Zvicër, si dhe për profesorin zviceran, mik i shquar i shqiptarëve, Basil Schader, i cili është edhe qytetar nderi i Lezhës. Atje ka ndihmuar shumë shkollat e rajonit. Nexhmija është tepër modeste kur më theksonte dje: “Unë nuk kam shkruar libër të përbashkët me profesorin e nderuar Basil Schader, por kam punuar në disa projekte të tij. Në projektin “Tekste mësimore për shkollën shqipe të mësimin plotësues në diasporë” unë dhe disa autorë tjerë kemi hartuar 18 teksteve mësimore për shkollat shqipe. Projektin “Doracak dhe libër pune” për mësimdhënien e mësimin plotësues, i përbërë prej Librit “Bazat dhe arsyet” dhe gjashtë pjesët e tjera. Seminare për ngritje profesionale etj; Konferenca për gjuhën shqipe, kumtesa ime “Ruajtja apo humbja e gjuhës shqipe në Zvicrën frëngjishtfolëse” të gjitha këto pashkëputje nga Shkolla e mësimin plotësues të gjuhës shqipe në Jura, ku kam themeluar në 1993 dhe aktualisht kam 80 nxënës”.

Ajo i shpreh këto me shumë modesti

që në fakt është një punë e madhe dhe shpesh vullnetare. Zonja e nderuar Nexhmije Mehmetaj thekson: “Shkolla shqipe në Zvicër ka formuar një traditë, shkollë tashmë në vitin e 28 të jetës së saj, shkollë tashmë me një histori të vetën, që lidhet me gjuhën e nënës, me fjalën e artë shqipe, atë fjalë që e ka mbledhë si blea nektarin lule më lule, Naimi, Asdreni, Pashko Vasa, Fishta, Kadare...”

A ka fjalë më të ndjera se këto që kjo mësuese e përkushtuar e gjuhës shqipe i transmeton brezit të ri shqiptar në Zvicër? Nexhmije Mehmetaj vazhdon për dekada të tëra të japë ndihmesën e saj të çmuar për përhapjen e gjuhës amtare tek brezi i ri në diasporë.

Nexhmije Mehmetaj e përkushtuar më theksonte edhe këtë shqetësim të saj të ligjshëm: “Ta ruajmë identitetin kombëtar e kemi domosdoshmëri. Dhe shenja e parë e identitetit është gjuha. Ta ruajmë gjuhën tonë, të flasim me fëmijët shqip, sepse ata janë e nesërmja, ata do ta përcjellin gjuhën shqipe nga brezi në brez, e ta ruajmë shqipen si sytë e ballit, se aty ku nuk flitet gjuha jonë jemi të tretur, të humbur”. Në shënimet e mija të mbajtura në Tiranë, gjeta ndër të tjera edhe shënimin tim: “Profesori im i nderuar, Nonda Bulka, shpesh na kujtonte gjatë orëve të mësimin, kur na jepte orën e letërsisë frënge, në vitet 1965-1969, poemën e bukur të Alfonse de Lamartine (emri i rrugës në Gjenevë ku unë banoj prej 25 vitesh, me bashkëshorten time të urtë, që më qorton se shkruaj shumë dhe marr kohë nga jeta ime që sa vjen e shkurtohet), me titull: “Simfoni shqiptare”. Ndër të tjera poeti francez, në poemë shprehet: “Shqipëria është vendi i herojve të të gjithë kohërave”.

A nuk ndihesh krenar dhe a mund të rrih pa shkruar kur ke përpara shënime të tilla të një poeti të madh apo shkrime si të profesoreshës së gjuhës shqipe në Zhyra (Jura) të Zvicrës, Nexhmije Mehmetaj. Ndoshta këto shënime po i hedh shpejt, pasi si çdo shqiptar po ndjek me ankth dhe interes zhvillimet e fundit të tensionuara politike në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe të miliona sovranëve të këtij vendi të bukur, si Zvicra, të lashtë, mikpritës dhe largpamës. Le të kthehemi tani përsëri tek tema jone fillestare. Në këto çaste, kur profesoresha e gjuhës shqipe Nexhmije Mehmetaj, më dërgoi shkrimin e saj të mëposhtem, për ta botuar para do kohësh, mendoja se edhe ajo është një nga heroinat shqiptare, paçka se Nexhmija do të më qortojë kur të shohë këto shënime të hedhura në letër, këtu në malin e Dajtit, ku u ngjita me teleferik. Si ato vitet 1965-69 kur ngjiteshim me profesorin e nderuar të fjalorëve dhe shkrimtarin Vedat Kokona, apo edhe njeherë me të paharruarin flokëgjatë dhe fisnik, Nonda Bulka. Nje miku im këtu, si edhe çdo shqiptar kur të sheh sidomos që vjen nga Diaspora, më dha ordinatorin dhe unë po hedh këto

rrështa, i emocionuar pasi lexova shkrimin e të urtës Nexhmije.

Ajo së bashku me kolegët e saj bëjnë një punë të çmuar dhe shpesh pa pagesë, që vocë raket tanë edhe pse të integruar në shoqërinë zvicerane, të mos harrojnë gjuhën e të parëve të tyre, të cilën e mbrojtën me gjak e sakrificë breza të tërë shqiptarësh. A ka simfoni më të bukur se kjo që po na dhuron Nexhmija sot? Ja le lexuesit ta vlerësojë. Nexhmije Mehmetaj është mësuese në Jura të Zvicrës. Ndërkohë ajo është një veprimtare e shquar e LAPSH-it, Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë. Në një nga projektet e shumtë ka bërë pjesë dhe projekti “Kamishibai”, ku është përfshirë edhe letërsia shqipe për fëmijë. Ky projekt, i quajtur “Kamishibai” i kushtohet gjuhësisë dhe integritit. Ideja e projektit lindi nga arsimtarët e kantonit Jura dhe nismëtare ishte arsimtarja e përkushtuar e gjuhës shqipe, Nexhmije Mehmetaj. Projekti është përkrahur edhe nga Zyra e integritit dhe lufta kundër racizmit në Delemont (anëtare e së cilës është dhe Nexhmija). Ajo është shprehur me entuziazmin e një profesoreshe të gjuhës shqipe, tepër modeste dhe fisnike, fjalëpakë: “Nuk ka qëllim më të bukur sesa të punosh që njerëzit të cilët do të vijin më pas të jenë më të lumtur sesa ishim ne. Lumturinë më të madhe njerëzimi e gjen duke u përpjekur për lumturinë e fëmijëve. Ndhimën së pari e meritojnë të vegjëlit, fëmijët, nxënësit, se për ta çelet e ardhmja. Fjala dhe vepra e mirë dëgjohej larg. Ky projekt jep një imazh të mirëfilltë gjuhës dhe kulturës shqiptare e cila nuk prezantohet shpesh në shkollat zvicerane. “Kamishibai” është një projekt i suksesshëm bashkëpunimi shkollë-institucion dhe kulturë amtare kushtuar integritit. “Kamishibai” është disi i panjohur për ne. Historinë e Kamishibait e gjejmë qysh në shekullin XVI në Japoni. Themeluesi i Kamishibait konsiderohet një edukator i shquar japonez. Pra emri rrjedh prej fjalës japoneze që do të thotë, kami – letër dhe shibaï teatër. Në fillim Kamishibai përdorej si mjet marketingu nëpër rrugë në formë spektakli. Pas viteve ’50-të të shekullit që lëmë pas Kamishibai ka gjetur përdorim edhe në pedagogji. Ku përfshinë strategjitë e të mësuarit, që fokusohen në mësimdhënien e fëmijëve në moshat 6 -7 -8 vjeçe. Themeli i Kamishibait si art i të mësuarit është ndërtuar në përshtatjen dhe përvetësimin e leximit për mes formës “ludique”(lojë). “Si shqiptare dhe mësuese, shprehet Nexhmija, ke gëzim kur merr pjesë në orën e mësimin në shkollën zvicerane. Sheh, bujarinë, korrektësinë, profesionalizmin, përpikërinë në punë. Njëkohësisht ndjen dhimbje shpirtërore kur dëgjon sa dobët artikullohet gjuha shqipe nga nxënësit tanë, sa pak vlerësohet ajo nga prindërit e tyre në të folur e në shkruar prej vetë shqiptarëve”. Më poshtë për lexuesit po jap disa mesazhe

FESTON 86 VJETORIN E LINDJES MBRETËRESHA E KËNGËS SHQIPTARE NEXHMIJE PAGARUSHA

AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ORGANIZON NJË KONCERT MADHËSHTOR PËR KËNGËTAREN E MADHE KOSOVARE NEXHMIJE PAGARUSHA, "NDERI I KOMBIT"

Para pak ditësh, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kosovë organizoi një koncert madhështor me rastin e datëlindjes së këngëtares së madhe Nexhmije Pagarusha, që në të vërtetë u kthye në një festë mbarëkombëtare në nder të kësaj embleme të melosit popullor, në nder të këtij bilbilit të këngës shqipe, që me zërin e saj do të mbetet e pavdekshme në Panteonin e muzikës shqiptare.

Në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, Ambasada Shqiptare organizoi një koncert solemn me rastin e 86-vjetorit të ditëlindjes së yllit shqiptar Nexhmije Pagarusha. Këtë mbrëmje e kishin nderuar me pjesëmarrjen e tyre shumë artistë, këngëtarë, miq e adhurues të shumtë nga të gjitha trevat shqiptare, të cilët ishin mbledhur që ta urojnë së bashku, por edhe të festojnë së bashku për këtë mbretëreshë të madhe të muzikës shqiptare.

Në këtë eveniment të mrekullueshëm përformuan këngëtarë me zë nga të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët, përfshirë Kosovën, Maqedoninë dhe Shqipërinë, pa anashkuar ata që jetojnë e punojnë në Evropë e SHBA. Ndër këngëtarët të cilët erdhën në Kosovë që me ëmbëlsinë e zërit të tyre të festojnë ditëlindjen e artistes së madhe Nexhmije Pagarusha, ishin: Shpresa Gashi, "Mjeshtri i Madh" Bujar Qamili, Shkurte Fejza "Mjeshtre e Madhe", Selami Kolonja, Era Rusi, Shyrete Behluli, Vjoleta Kukaj, Enkelejda Arifi, Rona Nishliu, Gresa Behluli, Learta Jakupi e shumë të tjerë.

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë,

z. Qemal Minxhozi, ndër të tjera tha: "Është privilegj pjesëmarrja në ditëlindjen e divës së këngës shqiptare Nexhmije Pagarusha, është privilegj për secilin prej nesh për të marrë pjesë në ditëlindjen e saj, sepse ajo vetë na ka frymëzuar për t'i bërë këtë dhuratë modeste për figurën dhe veprën e saj të çmueshme".

Mbrëmja filloi me performancën e Korit të Shkollës së Muzikës në Prishtinë. Më pas u ngjiten në skenë këngëtarë nga më të shquarit e muzikës shqiptare. Me duartrokitje të zjarrta u pritën performan-

cat e këngëtarëve Shpresa Gashi, Shkurte Fejza, Bujar Qamili, Selami Kolonja, Era Rusi, Rona Nishliu e shumë të tjerë.

Në këtë mbrëmje të konceptuar e realizuar si një koncert festiv u recitua edhe një poezi nga artistja Safete Rugova, e po ashtu u kënduan edhe këngë kushtuar Nexhmije Pagarushës.

Qershia mbi tortë ishte një nga këngët kushtuar këngëtares së madhe kosovare, titulluar "Laresha Kosovare" që u interpretua në këtë mbrëmje. Ajo ishte kompozuar nga një tjetër artiste e madhe, muzi-

kantia e njohur Pranvera Badivuku dhe u interpretua nga këngëtari i njohur Selami Kolonja për herë të parë në ditëlindjen e 86-të të Bilbilit të Kosovës.

Në këtë shkrim do të shpreh edhe unë kënaqësinë e madhe që sjell edhe për mua, për krijimtarinë time si poet, bashkëpunimi me kompozitorin virtuoz, profesorësh Pranvera Badivuku, orkestruesin Kreshnik Aliçkaj, Kujtim Shalen për regjistrimin e vokalit në studion e tij në Pejë dhe këngëtarin e mrekullueshëm



që jep profesoresha Nexhmije Mehmetaj për të folmen shqipe në Zvicër. Ajo shprehet ndër të tjera: Ngulimi i shqiptarëve në Zvicër është themeluar, në valë të ndryshme, në një hark kohor që kap mbi 40 vjet. Dihet se në Zvicër banojnë disa grupe të popullsisë shqiptare: Shqiptarët nga Shqipëria, shqiptarët nga Kosova, shqiptarët nga viset shqiptare të Maqedonisë, shqiptarët nga Kosova Lindore (Serbi jugore), shqiptarët nga viset shqiptare të Malit të Zi. Pra vendi prej nga janë dyndur shqiptarët janë më shumë nga Kosova. Deri në vitet '90 të shekullit që lamë pas, vlerësohet se në Zvicër nuk kishte më shumë se 120 mijë shqiptarë, kurse sot mendohet se janë rreth 200 mijë shqiptarë. Numri i madh i mërgimtarëve kanë përtëritur dhe shtuar dukshëm elementin shqiptar e gjuhën shqipe në Zvicër. Krahas kësaj shtrohen pyetjet që i përkasin një trajtimi kryesisht sociolinguistikë. 1. Kush flet shqip në Zvicër, cila është gjendja e sotme gjuhësore e tyre dhe a ka shqiptarë që flasin vetëm shqip dhe nuk dinë as njërën nga gjuhët zyrtare të Zvicrës? 2. Kur flitet shqip dhe kur frëngjisht nga shqiptarët e Zvicrës? 3. Në ngulimet shqiptare në Zvicër a ka dygjuhësi në kuptimin e

mirëfilltë të fjalës? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve do të mbështetemi në gjykimin tonë të formuar nëpërmjet kërkimeve dhe anketimeve rreth të folmeve shqipe në kantonin Jura të Zvicrës. Kërkime të pjesëshme e, sidomos, plotësime të materialeve e verifikime kam bërë disa herë edhe gjatë periudhës dy vjeçare 1995/97, duke mbledhur nga nxënësit fjali me përzjerje shqip – frëngjisht. Pyetja e parë, që shtruan më lart, lidhet me zanafillën e numrin e ngulimeve shqiptare të Zvicrës, me kohën e vendin e shpërnguljes së tyre, si dhe me numrin e sotëm të banorëve të këtij komuniteti. Sipas të dhënave më të fundit të studiuesit të shquar zviceran prof. Dr. Basil Schaderit, popullsia shqiptare në Zvicër përfshin nga 160'000 – 175'000 njerëz. Në shkrimet e vetë shqiptarëve ky numër na del më i madh. Është vështirë për t'u përcaktuar me saktësi numri i shqiptarëve në Zvicër, dokumentet heshtin në këtë pikë. Porse dihet prejardhja e tyre nga vende të caktuara shqiptare. Mendimi i përgjithshëm i studiuesve është se nuk ka qytet as fshat në Zvicër që nuk ka shqiptar. Shqiptarët që sot jetojnë në Zvicër kanë mbetur të lidhur fort me atdheun, nuk i këpusin lidhjet shpirtërore me vendlindjen e tyre.

Është e kuptueshme, prandaj, pse ata nuk i fillojnë herët përpjekjet për një jetë më të organizuara politike dhe kulturore në mërgim. Proceset migruese e kanë ndryshuar dukshëm strukturën demografike të mërgimeve tradicionale shqiptare. Një numër i mirë shkrimtarësh, mësuesish, gazetarësh dhe veprimtarësh shqiptarë njohin, zotërojnë dhe, sipas rastit, përdorin me shkrim ose me gojë edhe gjuhën letrare shqipe. Shqipja e diasporës shqiptare në Zvicër është kryesisht një idiomë e folur, e mësuar dhe e shkruar në shkollat e vendlindjes. Të gjitha këto tregojnë se shqipja vijon të jetë një gjuhë kulture e folur dhe e shkruar, tri gazeta shqipe dalin dhe botohen prej shqiptarëve të Zvicrës. Kultura shqiptare është një element konstituiv i bashkësive të sotme shumë kulturore të Zvicrës në gjë të cilës po integrohen shqiptarët. A ka fjalë më domethënëse se ato që shpreh mësuesja e përkushtuar Nexhmije Mehmetaj: Një fjalë e urtë e popullit thotë: "Kush mbjell një arë me grurë punon për një vit, kush mbjell një pemë punon për dhjetë vjet, kush hap një shkollë punon për njëqind vjet". Shkolla e mësimit plotësuese të gjuhës shqipe në Jura u krijua më 1993 dhe vazhdon punën e saj edhe sot. Ky fakt

tregon edhe për punën me nivel që bëjnë prindërit shqiptarë për të mbajtur lartë ndërgjegjen kombëtare. Parimisht në këtë drejtim është bërë një punë e mirëfilltë në dy drejtime: E para në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare dhe e dyta: në ruajtjen e gjuhës amtare nga fëmijët e mërgimtarëve. Rolin kryesor në mësimin e gjuhës shqipe e kanë prindërit. Duke mësuar gjuhën shqipe fëmijët tanë, do të pasurojnë kulturën e tyre, dhe më e rëndësishmja, veç përvetësimit të gjuhës amtare, do të përfitojnë edhe traditat dhe zakonet e mira që populli ynë ka trashëguar në shekuj". Këtu përfundon, të nderuar lexues shkrimi i profesoreshës Nexhmije Mehmetaj të cilin kam bindje se e keni pëlqyer. Do ti kthehem përsëri punës të saj, që ajo e quan modeste, por që vlen shumë më tepër, për mbajtjen gjallë të gjuhës amtare shqipe, për brezin e ri që ndodhet në diasporë në Zvicër, SHBA, Kanada, Britaninë e Madhe, Francë e gjetiu, për Elynën, Marion, Amelian, Alesian, Mian, Iszabelën, Ebrin, Tonin, Krisin, Dionin, Emin e mijra e mijra të tjerë. Artikullin e plotë mund ta lexoni në faqen online të të të .kohajone.com "Të ruajmë identitetin kombëtar, gjuhën tonë".

◀ Selami Kolonja, me këngën kushtuar Nexhmije Pagarushës, me titull «Lauresha Kosovare», e cila u mirëprit me shumë sukses nga të pranishmit, duke krijuar një emocion të jashtëzakonshëm si për publikun, ashtu edhe për mbretëreshën Pagarusha.

Të gjithë i uruan nga zemra që të arrijë shekullin, jo vetëm me një shëndet të plotë dhe jetë të lumtur, por edhe me zërin si Lauresha e Këngës Shqiptare. Ta dëgjofshim gjithmonë zërin tënd të bukur o zonzj e nderuar shqiptare!

Kompozitorja Pranvera Badivuku, tha që inspirimi për të kompozuar këtë këngë kushtuar Nexhmijes, i kishte ardhur nga teksti i cili ishte shkruar më herët nga tekstshkruesi shkodran Ramazan Çeka. “Unë i kam kushtuar dy këngë më herët këngëtares sonë të madhe që është zë i artë i këngës shqipe, por këtë rast më ka inspiruar tekstshkruesi Ramazan Çeka nga Shkodra, i cili e ka postuar këtë tekst para vitit të ri. Unë e gjeta atë që titullohej “Lauresha Kosovare”. Ky ka qenë pra inspirimi i tekstit që unë vendosa ta bëj këngë. Po më vjen mirë që kënga u realizua para ditëlindjes së saj dhe është një dhuratë për të” u shpreh Badivuku.

Ndërsa edhe këngëtarja Selami Kolonja shumë i emocionuar u shpreh mjaft sentimental në lidhje me këngën që këndoi me aq shumë dashuri dhe sipas tij kishte një ndjenjë të veçantë. “Para vitit të ri më thirri kompozitorja dhe më tha që e kam shkruar një këngë për Nexhmije Pagarushen, ishte një nder shumë i madh që unë u përzgjodha për ta kënduar këtë këngë. Ishte një këngë që e kam sjellur dhe e kam kënduar me shumë dashuri”.

Kështu spektakli vazhdoi me një atmosferë të paparë falë performancës brilante të këngëtarit Bujar Qamili, i cili gjatë interpretimit të këngës u shoqërua nga duartrokitjet e të pranishmëve, duke e shoqëruar vetë Pagarusha me zë të lehtë nga vendi ku ishte ulur.

Pas interpretimit me shumë sukses, Bujari duke e uruar nga zemra këtë zonzj të madhe të këngës tha se sot po më duket vetja sikur po këndoj për herë të parë. Jam shumë i lumtur tha ai që me ftesën që më bëri Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë z.Minxhozi u bëra pjesë e këtij eventi kaq madhështor. Nuk do ta harroj kurrë këtë mbrëmje kaq të bukur.

Edhe pse e lodhur nga mosha, entuziazmi i Nexhmije Pagarushës nuk mungoi në ngjarjen e rëndësishme kushtuar ditëlindjes së saj, madje u shpreh e mahnitur me këtë organizim meqë ishte hera e parë që bëhej diçka kaq e madhe për të. “Nuk kemi pasur rast të kemi një koncert të tillë kurrë në Kosovë, i falënderohem ambasadorit shumë, shumë. Nuk kam fjalë edhe besoj se të gjithë janë duke e ndjerë vetën të lumtur. Janë mbledhur të gjithë artistët sonte këtu edhe ata janë të lumtur edhe publiku është i lumtur e sidomos unë, ju falënderoj shumë” tha ajo mes emocioneve të mëdha që diktonte prania aq e madhe e miqve, artdashësve e kolegëve.

Nexhmije Pagarusha është një këngëtare dhe aktore shqiptare, e cila njihet si mbretëresha e muzikës shqiptare. Me një karrierë të ndritur Pagarusha është e njohur për interpretimet e saj të shkëlqyera në muzikën popullore dhe atë



klasike.

Mbretëresha e këngës shqiptare Nexhmije Pagarusha është një artiste që ka krijuar personalitetin e saj jo thjesht nga karriera e gjatë, por nga gërshetimi i saj me talentin e profesionalizmin, me pasqyrimin në krijimtari të frymës dhe vlerave më të mira të artit e kulturës sonë kombëtare.

Këngët e saj të mrekullueshme, lirizmi, pathozi i zjarrtë që i mbushte zemrën penetronte në zemrat dhe familjet e çdo kosovari edhe atëherë kur hija e rëndë e nacionalizmit serb rrinte si një re e zezë mbi qiellin e Kosovës. Këngë të tilla si “Baresha”, “Zambaku i Prizrenit”, “Kosovarja e bukur”, “E kujtoj atë takim” etj do të mbesin të pavdeshkshme bashkë me zërin e kësaj këngëtaresje të madhe.

Për vlerat e saja të mëdha si një artiste e madhe ajo do të dekorohet edhe nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Donald Trump e ka dekoruar me medaljen e «Mirënjohjes», mbretëreshën e muzikës shqiptare, Nexhmije Pagarusha. Çmimi i mirënjohjes iu akordua këngëtares Pagarusha përmes propozimit të një Akademie në Florida, i cili është çmim periodik vjetor që firmoset nga Presidenti amerikan për Personalitete që kanë impakt mbi njerëzit dhe shoqëritë e tyre, konkretisht në fushën e artit. Për nder të ditëlindjes së saj ju rikujtojmë se ky çmim iu dha vitin e kaluar si një ndër çmimet më të rëndësishme në karrieren e saj.

Në ceremoninë e organizuar për 85-vjetorin e artistes së madhe shqiptare në Akademinë e Arteve në Tiranë, nga Shoqata Rëss-Egnatia dhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, ishin të pranishëm Presidenti Ilir Meta, personalitete të fushave të ndryshme nga Shqipëria dhe Kosova, familjarë, miq, artistë dhe artdashës.

“Mirë se ju gjeta. Kurrë s’kam menduar që do të vijë ky moment kaq i rëndë-

sishëm për mua, kaq i dashur dhe unë kaq e lumtur jam. Nuk di kush është më i kënaqur, unë që jam me ju, apo ju me mua”, u shpreh artistja e madhe, Nexhmije Pagarusha.

Nexhmije Pagarusha gjatë gjithë karrierës së saj i ka shërbyer me nder dhe dashuri atdheut përmes artit dhe vlerave të mirëfillta. Kujtojmë se ajo asnjëherë nuk ka pranuar të këndojë diçka që i tejkalon vlerat shqipe e që lë pas dore muzikën e mirëfilltë shqipe. Këtë më së miri e dëshmon anulimi i një koncerti në Maqedoni, ku i është kërkuar të këndojë në gjuhën

po veçojmë kompozitorin Naim Krasniqi, i cili kishte bërë një krijim ku Nexhmija nuk këndon por reciton. Një pothuajse “lamtumirë” edhe kur nuk do të jetë me këtu.

Këngëtarja simpatike dhe çapkëne Era Rusi gati e përplotur u shpreh: “Kur të jep bekimin Nexhmije Pagarusha është vlerësimi përkëdhelës i emblemës së këngës për mua dhe karrieren time...E dehur nga emocion...Jetë të gjatë, me këngë në buzë”.

Mrekullia e kësaj mbrëmje ishte edhe prezantimi i përkryer nga moderatorja



serbe dhe artistja është larguar nga skena.

Në mes të shumë urimeve, mbretëreshën e muzikës shqipe, me rastin e 86 vjetorit të lindjes e ka uruar edhe një tjetër mbretëreshë e muzikës popullore shqipe znj. Shkurte Fejza, dhe është e pamundur të përshkruaj emocionet që krijoi para të pranishmëve në fjalën e saj, e cila me shumë dashuri tha: “Gëzuar ditëlindjen Primadona e këngës së bukur shqipe.

Kjo legjendë e këngës shqiptare ka bërë histori suksesi në Kosovë e Shqipëri dhe emri saj është gdhendur në zemrat e shumë bashkëkombësve. Të uroj edhe shumë vite të lumtura në mesin tonë”.

Me shumë emocione u shprehën pas koncertit këngëtarë e artistë të shquar ku

simpatike Alketa Gashi, që me aftësitë e saj brilante, me buzqeshjen e saj të bukur dhe të sinqertë, me finesën e saj, me profesionalizmin dhe improvizimet që ajo krijoi në mënyrën më të përkryer, zbukuroi skenën dhe i dha larmi këtij evenimenti, duke na dhuruar kënaqësi dhe emocione të jashtëzakonshme.

Një meritë të veçantë ka edhe orkestra e shkëlqyer “Grupi Nadit”, i cili bëri të mundur që këngëtarët të performonin live. Eventi u transmetua drejtpërsëdrejti nga RTK si dhe ishte lajmi kryesor në të gjithë mediat vizive dhe të shkruara.

Nga RAMAZAN ÇEKA
Maj 2019

EFEKTET KOLATERALE TË TELEVISIONIT NË TRURIN E NJERIUT



Suela Ndoja

Në median vizive të gjithë shohim dhe dëgjojmë informacione të ndryshme (fenomene negative si vrasje, dhunë fizike, divorce, krime, përdorim i lëndëve narkotike, politikë etj) të cilat prodhojnë efekte të ndryshme dhe me të drejtë mund ta quajmë se televizioni është një armë psikosociale. Ka të tjerë të cilët mund të mos jenë të këtij mendimi.

Megjithatë shumë mund të jenë dakort se efektet fizike, përmbajtja e shumë programeve që ne shohim në ditët e sotme

janë projektuar për të ofruar një vizion social të botës që na rrethon. Njerëzit ndërtojnë sisteme vlerash kundërshtarë nëpërmjet televizionit që në përgjithësi krijojnë edhe perspektivën individualiste egoiste kundrejt asaj kolektive të shëndetshme. Thënë kështu, kemi të bëjmë me ndikime të shumëllojshme sepse shumë nga njerëzit nuk e përpunojnë se çfarë përmban në vetvete një informacion/lajm që shohin e dëgjojnë. Në këtë mënyrë informacioni i marrë nëpërmjet medias përkthehet në një ndijim të përgjegjësisë personale i cili vjen e zhduket nën vorbullën e një shumëllojshmërie të informacioneve dhe lajmeve të cilat në vetvete përbëjnë nevojën e shëndetshme të qytetarisë për të mbijetuar "duke qënë të informuar mbi realitetin".

Televizioni padyshim ka meritat e veta lidhur me përgjegjësinë e përgjithshme. Njerëzit kalojnë shumë kohë përpara televizionit dhe shpeshherë edhe në mënyrë të pavetëdijshme formojnë opinionione personale bazuar vetëm në ato që marrin nga opinionioni public.

Mirëpo çfarë ndodh në trurin e njeriut? Cilat janë efektet? Në nivelin

fizik, televizioni godet trurin duke ia bërë atë një vatër të përshtatshme për t'ia mbushur plot e përplot. Thjesht vetëm të mendojmë lidhjen e syve me trurin që përbën dritaren më transparente për të lejuar që të hyjë në thellësitë e trurit.

Truri i njeriut funksionon nëpërmjet katër frekuencave të ndryshme; beta, alfa, theta dhe delta.

Valët beta formohen kur jemi duke menduar, valët delta janë të lidhura me gjendjen e gjumit. Drita ndërmjetësuese e televizionit indukon trurin për të ndezur një nivel që qëndron ndërmjet valëve alfa dhe theta që është një gjendje e përgjumur në të cilën funksionet më të mëdha celebrale janë të fikura. Edhe kur lexojmë në ekranin e televizionit rregjistrohen nivele të valëve alfa. Valët theta përfshijnë vetëdijen dhe intuitën. Çfarëdo informacioni që marrin nga televizioni e tejkalon logjikën, mendimi kritik shkon drejtpërdrejtë në zonat e mendjes që lidhen me reagime më emotive. Kështu TV i bën kryesisht apel emocioneve, për këtë arsye qëndrojmë fizikisht të lidhur pas televizionit.

Kërkuesit shkencorë kanë zbuluar që sapo ndizet televizori, hemisfera e majtë e trurit dhe të gjitha fakultetet mendore fikën.

Tani, le të reflektojmë se çfarë ndodh në trurin e secilit prej nesh kur ne marrim një informacion i vërtetë apo i simuluar të jetë... Në këtë moment ne fillojmë të mendojmë mbi ngjarjen e dëgjuar dhe të parë në media.. në këtë rast po aktivizojmë valët beta. Nëse ne e rregjistrojmë të pjesshëm apo të plotë në kujtesën tonë, kjo mund të na rishfaqet edhe në gjendje gjumi në formë ëndrrë. Ndërkohë nëse ne vazhdojmë në mënyrë të vazhdueshme të fokusohemi pas dritës ndërmjetësuese të ekranit të televizionit në mënyrë të pavetëdijshme jemi duke u futur në kurthin e valëve theta dhe realitetin tonë e kthejmë në gjendje përgjumësie dhe në këtë mënyrë nuk bëjmë gjë tjetër veçse jemi duke shkëputur koordinimin e veprimeve reale të jetës tonë.

Prandaj, të mos lejojmë që televizioni të shuajë refleksat e mrekullueshme të jetuarit në realitet me trurin tonë i cili krejtësisht natyrshëm mund të japë një komandë të thjeshtë: fikeni televizionin. Të parshatemi me mendjen tonë për të krijuar opinionione personale rreth asaj që ndodh dhe që është duke ndodhur rreth nesh, me logjikën tonë, me emocionalitetin tonë në mënyrë që të jetojmë plotësisht në gjendje të vetëdijshme.

DHURATA DHE KONCEPTI I SAJ



Përgatiti, Ndue Ziqi

Në zhargonin e përditshëm ne hasim llojë, llojë fjalësh, nga më të ndryshmet në kuptim e përmbajtje. Shpesh herë këto fjalë janë të mira, shprehin dashuri e respekt, ashtu si ka edhe fjalë të rënda për individ, madje edhe për shoqërinë në tërësi. Në mesin e fjalëve, hasim edhe fjalën "dhuratë".

Çdo gjë e dhuruar është një kënaqësi, qoftë edhe një mirënjohje, një përfaqsim një kafe e të tjera. Kuptohet, se njerëzit shkëmbejnë dhurata në raste datëlindjesh, martesash, përvjetorësh e të tjera.

Dhurata bëhen edhe për humanizëm, sidomos për njerëzit, familjet në nevojë. Kuptohet se këto dhurata bëhen me shpenzimet e vet dhuruesve. Dhurues ka plot, madje edhe biznesmen të fuqishëm, të cilët nga fitimet e tyre ndajnë një pjesë për t'u dhuruar të varfërve. Dhurata bëjnë edhe organizata jo qeveritare. Madje dhurata të fuqishme bëjnë institucionet fetare më të theksuara nga Kishat, por edhe nga Xhamiat e Teqet.

Mediat vizive dhe ato të shkruara informojnë, se çdo javë ka dhurata shtëpiash, ushqime e veshmbathje për shtetas në nevojë. Dhurojnë edhe para përkurimit e të sëmurëve në shtetet e tjera. Pasi për shumë arsye nuk mund të kryhen në Shqipëri. Çdo ditë shtohen personat e familjet, të cilët kanë nevojë për ndihma e këto të përkthyer në dhurata.

Kuptohet, se kanë kaluar 30 vjet nga regjimi diktatorial, por qeveritarët tanë, kanë të njëjtat koncepte.

Dikur thuhej, se dhurata më e madhe e Partisë ishte njeriu i ri. Partia na dhurojë hidrocentrale, rrugë, sheshe, kanale kulluese e ujtitse. U kolektivizua bujqësia madje u bë tufëzimi i oborrit kooperativist që e vulosi ende më shumë varfërit e fshatit. Po të gjitha këto u bënë me djersë në këmbë të popullit të raskapitur. Me të gjitha këto dhurata e ne përsëri mbetëm vendi më varfër në Evropë. Dhe tani qeveritë dhurojnë sheshe e rrugë, kopshte e çerdhe, qendra shëndetësore e ambulanca.

Reklamë e fasadë, çdo ditë ekranet e mediave vizive mbushen me udhëheqës duke folur kuturu. Vetëm për të tërhequr vëmendjen nga hallet e shumta të këtij populli.

Në vitin 1936 është hapur rruga e makinës për në Theth. Por asnjëherë nuk është thënë, se e keni dhuratë!? Me gjithë atë, tani ajo është më keq se para 83 vitesh. Me dhjetra herë kanë premtuar, se do ta rregullojmë atë rrugë. Me sa duket presin ndonjë PPP të "majëm" ku ta nxjerrin fitimin. Se tani as borën nuk e kanë pas-truar. Po kanë nxjerr një traktor DT të kohës qepës dhuratë e kryetarit Mao... Më shumë për tu tallur se sa për punë. Mbase edhe këtë e quajntë dhuratë.

Me që erdhi fjala për Kinën, por i kthehem në rotorspektivë. Kishin sjellë patate nga Kina shumë vite më parë. Një ko-

operativistë pasi ngarkon thesin, pyet nga na kanë ardhur këto kërtolla? Magazinieri i tha na i ka dhurue Mao Ce Duni. Ky me ironi i thotë i shkoshin për shpirt të Dunit! Mendojë se banorë të Dukagjinit edhe për traktorin të luten për shpirtin e Maos. Tani ndonjë ditë shitësi do thotë se të dhurova një televizor, edhe pse i ke paguar paratë kokërr në kokërr. A nuk i kemi paguar ne taksapaguasit të gjitha ato që janë ndërtuar? Madje, me kosto të tre e katërfishta. Ka disa objekte të cilat kanë futur në borxh edhe ata që ende nuk kanë lindur?! Si rrugët, PPP e famshme e të tjera.

Inagurohet një urë mbi lumin e Lanës, e cila lidhë dy lagje të vjetra tiranse. Gjatë inagurimit, në fjalim e sipër thuhet, ju dhuroam dy lagjeve një urë për tu lidhur. Kjo dhuratë e paguar sa "fregupulen" nga taksat e qytetarë ve varfanjak! Se pushtetari nga paga e tij ka dhënë vetëm taksën si gjithë të qytetarët e tjerë. Si mund ta quajmë dhuratë!?

Një burrë i zgjuar dukagjinasi tha: "Edhe drejt ka dy gjëra të mira: E para, atë e ke pranë gjithmonë! Së dyti, çfarë ti japësh e merr".

Ne gjithmonë qeveritë i kemi pasur pranë, për mirë apo për keq le ti gjykojmë!?

S'ka ma rrënoqethë se, kur bën llogarinë për ato çfarë jep e merr!?!...

A nuk i dha më rreth 15 herë votat e mendojë, se ja dhuroam drejt. E përsëri ne vendi më i varfër në Evropë. Se paratë e pasuria u përdorën në duart e një grupi harpagonesh të pa ngopur. Në dukagjinasi kemi të drejtë të jemi xhelozë dhe për zonat, me të cilat kufizohemi. Kur sheh infrastrukturën e tyre.

Më konkretisht. Nga Tirana e në majtë të Vermoshtit udhëton në rrugë të asfaltuar. Nga Tirana deri në qendër të Lekbibar-

je të Tropojës, rruga është e asfaltuar.

Po të njëjtën gjë mund të themi edhe për rrugën nga B. Curri deri në Fushë të gjesë në Rragamin e Shalës. Edhe Guçia asfaltin e ka deri afër Thethit. Pra, dy orë këmbë nga Thethi.

Ne u ndalëm për rrugët. Po të bëjmë bilançin, se sa investime janë bërë në zonën e Dukagjinit, sa shkolla të reja, ambulanca, sa km rrugë janë bërë, me lidhë fshatrat brenda njësave administrative për këto 30 vjet?! Bilançi del nën "0". Jo, që nuk ka pas investime, po janë shkatërruar edhe ato ndë rtime ekzistuese?! E tmerrshme!?

Këto ditë fillon fushata për zgjedhjet vendore. Krahas disa punëve me pikatore, që po bëhen, tani presim dhurata me fjalë, se në realitet nuk ka shanse, për realizime të mëdha. Do përsëriten ato të disa viteve më parë, ku në mes të tyre do jenë ato rrugë që lidhnin Dukagjinin me Shkodrën. A mos ka ardhur koha të bëhemi bashkë të gjithë?

Me jua bërë të qartë, se nuk do votojmë pa u miratuar fondet dhe të fillojmë punimet në këto akse rrugore, të cilat janë jetike për këtë trevë të njohur në të gjithë botën.

Le të jemi të vendosur, e të palëkundur. E mbi të gjitha për ti detyruar strukturat shtetërore t'i rikonstruktujnë, në parametrat e atyre rrugëve të cilat i cituam më lart.

Përsëri shpresa vdesë e fundit.

I urojmë të na japin "Dhuratë" të vërtetë, por pa pas drejtësinë me vete, ndryshe votë n' do ta marrin as si dhuratë më!

Në një shtet të vërtetë demokratik premtimet janë flori, nëse realizohen në kohë e me cilësi. Atë herë po: Shndrohëni në dhuratë shkëlqimi si dielli!

PYESIN MALET E DUKAGJINIT: PSE E AKUZONI KËTË FARË TRIMI?

REAGIM DHE PËRGJIGJE PËR FASHISTËT SHQIPTAR ARGON TUFA E ÇELO HOXHA DHE TËRË MBETJEVE SEPTIKE TË NAZIFASHISTËVE, NGA NIPI I "KRIMINELIT" ME NUMËR 65 NË LISTËN E NJË PSEUDOINSTITUTI KUPLARAJE, ANTISHQIPTAR.

Nga: Ndoc Logu

Jo vetëm pas ndarjes nga jeta reth 30 vjet të kaluara, por edhe më parë, shumë shokë, miq, dashamirës dhe bashkëkohës të Gjon Marashit, më kanë kërkuar disa herë të shkruaja një monografi kushtuar atij, ku të shkrihet e tërë historia e kësaj familje në 200 vjetët e fundit. Këtë nuk e kam bërë i nisur nga një traditë modeste reale, jo e shtirur, e familjes dhe e krahinës sime të Dukagjinit. Kjo edhe për faktin se jam djali i vëllait të tij. Edhe pse ai e meriton, edhe pse unë, kam mbi 500 faqe dokumente e shënime nga jeta dhe veprimtaria e tij që nga viti 1910 kur kapi pushkën në moshën 16 vjeç kundër pushtuesve dhe sunduesve, derisa ndërroj jetë afro një shekull. Për këtë ka ndikuar edhe fakti tjetër se: Gjon Marashi, që nga rinia e hershme, ishte njeri nga djemtë, më pas burrat, luftëtarët atdhetar nga më të njohurit e krahinës e më gjërë. Fjalët e mia sado të gjetura të ishin, nuk mund të arrinin në ato përmasa dashurie, respekti e vlerësimi të arët që kishte populli i Dukagjinit për të. Gjon Marashi, ishte kthyer në një figurë emblematiske, përfaqësuese, dhe mbarëpopullore në Dukagjin e më gjërë. Tani që kori i korbave të pas viteve 90-të nga bijët e tradhtarëve të 75 vjetëve më parë, që Gjon Marashi i kishte sfiduar disa herë, kanë filluar të njollosin historinë dhe të akuzojnë Gjon Marashin si "kriminel", duhet patjetër t'u thuhet e vërteta se kush ishte në të vërtetë Gjon Marashi dhe cilët ishin ata që u përballën me të 80 vjet më parë, apo edhe përpara pushtimit më 1939.

Duke qënë nga kjo familje ku një djalë i jonë dha jetën në mbrojtje të besës dhe vlerave të tjera të krahinës, me pushtuesit më 1816, më pas në dy të dënuar me vdekje në mungesë nga regjimi tradhtarë zogist, duke qënë me 5 (pesë) pjesëmarrës në LANÇ, me 3(tre) djem ra në krye të detyrës, që të tre dëshmorë, me 2 (dy) të vdekur me plagë lufte në trup dhe që të gjithë, papërrjashtim, gjithmonë e për çdo çështje, të vendosur në anën e duhur të historisë, duke qënë pasardhës i këtyre dëshmorëve, detyrohem të reagoj në formën e mëposhtme, kundër atyre që e kanë shpallur atë listë me "kriminel" që në të vërtetë janë heronj të pavdekshëm dhe dëshmor të lavdishëm të atdheut.


Veprimtaria e prej disa viteve e Agron Tufës dhe e shpurës çakejve të tij, në atë çerdhe gjarpërinjsh ku grumbullohet helmi i tërë fëlliqësirave të kombit mbi 80 vjetësh, e më pas shpërndahet në tërë hapsirat kombëtare, duhet marrë shumë seriozisht. Duhet marrë me të njëjtin seriozitet si me baballarët e tyre 1939-1990. Të 30 vjetët e fundit na vërtetuan faktin

e pamohueshëm se: qëndrimi ndaj këtij reaksioni kriminelësh e tradhtarësh, pas-ka qënë plotësisht i merituar. Jeta vërtetohet se jo vetëm ata që lanë kërmat përkrah pushtuesve, jo vetëm ata që ikën e ngordhën si skllëvër në shërbim të armiqve të popullit të vet, jo vetëm këta që mbetën këtu për të dëshmuar tradhëtisë dhe krimet e kryera, apo të tjerë që erdhën pas vitit 1945, për të realizuar ëndrrën kriminale të të parëve, por as soji i tyre që mbinë nga fosilet e të parëve, nuk paskan kuptuar asgjë nga historia e tyre tragjike. Nuk paskan mësuar asgjë nga e kaluara e tyre e turpshme dhe e përgjakur. Këta po na thonë hapur "Jemi gjallë... Jemi këtu... Jemi si baballarët tanë para 75 a 80 vjetësh..." Ne pasardhësit e atyre që bënë luftën dhe sollën lirinë, ne pasardhësit krenar të emrave në atë listë heronjsh e dëshmorësh të lavdishëm, që fashistët e sotëm i quajnë "kriminel", tërë atdhetarët që e duan Shqipërinë dhe lirinë, duhet t'ju themi: "Edhe ne këtu jemi... Ju njohim mirë dhe nuk ju harrojmë kurrë. Koha 30 vjeçare e tranzicionit solli lirinë që ju nuk e paskeni merituar". Ne do t'u themi atë që ju tha poeti 24 vjeçar meksikan Oktavia Pas, fashistëve spanjoll "No pasaran" (nuk do të kaloni). Nuk do t'u harrojmë asgjë, as rrënimin që i bëtë pasurisë kombëtare dhe tërë Shqipërisë. Tani ju kini sulmuar, si hienat, historinë e luftës dhe vlerat e saj. Por nuk do t'ia delni.

Tufa dhe korbat e tjerë rreth tij që na paskan jetuar në burgje apo puseta septike, e paskan kaluar kohën e inkubacionit dhe kanë dalë hapur. Shpallja si "kriminelë" i tërë udhëheqësve ushtarak e politik të gjitha njësive e formacioneve luftarake të LANÇ, kundër nazifashizmit, duhet konsideruar një kushtim i tërë atdhetarëve, ashtu si me 7 prill 1939. Por me një ndryshim: në 1939 na pushtuen të huajt. E sot, me 2019, fashizmi na lindi brenda vet popullit tonë, i ushqyer nga taksat tona. Kjo është shumë më e rëndë, më e vështirë dhe më e rrezikshme. Kjo nuk duhet toleruar. Është toleruar tepër. Tërë gjarpërit shtypen nga koka. Ndërsa këta gjarpërit shqiptar, duhen shtypur jo vetëm nga koka, por edhe nga trupi dhe bishti. Kjo për faktin se, fashizmi italo-gjermano-japonez, sulmoi popujt e tjerë. Ndërsa këta fashistët tanë, kërkojnë hakmarrje ndaj antifashistëve të vet shqiptar. Ne se i lejojmë këta gjapërit të lëvrijnë, nesër do të shkelin mbi gjakun dhe kofmat tona. Këtë kanë bërë edhe baballarët e tyre pas 7 Prillit 1939. Këtë duan të bëjnë sot bijtë bastard të tyre.

Autori i këtij shkrimi, është një individ dhe disa familje, që na akuzon ku Insti-

tut kuplaraje me të pavërteta. Në numrin 65 të kësaj liste me emra të lavdishëm, radhitet edhe axha im Gjon Marashi, ish Konandant i Çetës së Dukagjinit. Madje, ai, është organizatori dhe komandant i saj. Çeta e Dukagjinit ishte i pari formacion luftarak në Qarkun e Shkodrës, pasi filloi Lufta e Dytë Botërore. A e meriton Gjon Marashi këtë akuzë, nga shqiptarët e vet,



sot më 2019, në 125 vjetorin e lindjes, në 75 vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë, i cili mori si "dekoratë" dy plagë në trup, duke i "dhuruar" lirisë edhe jetën e djalit, tani që ka mbi 30 vjet që ka ndërruar jetë? Po të bëhej kjo nga çdo pushtues apo të gjithë së bashku, edhe mund të quhej e prenuar, po të bëhej nga shqiptarët kur-rësesi jo. As axha im, asnjë në atë listë nuk e meritojnë këtë akuzë. Ata meritojnë nderimet e tërë kombit dhe përjetësisht. Autorëve të listës, dua t'ju them se, axha im, tërë ajo listë heronjsh, nuk i kriminalizoni dot. Ju harroni se Heronjtë nuk vdesin, por marrin plagë. Heronjtë, qoftë kur vriten, qoftë kur rivriten nuk qahen. Ne të dy rastet, plagët e heronjve, ua shtojnë shkëlqimin, i bëjnë të paharruar në kujtesën e brezave. Lista e publikuar nga ai pseudoinstitut antishqiptar, ne pasuesit e tyre, nuk na turpëron. Na bënë krenar, sepse misioni i tyre ishte i shenjtë, ishte shpëtimtar për atdheun e popullin. Lufta dhe sakrificat e tyre solli lirinë, sovranitetin e vendit dhe fundin fatal të pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve nga gjiri ynë. Nga ana tjetër, dëshmorët dhe heronjtë e asaj liste, të gjithë papërrjashtim, si ata që dhanë jetën në betejat e përgjakshme, si ata që vdiqën nga plagët e luftës në trup, si të tjerët që patën fatin të shijojnë lirinë dhe të rimëkëmbin Shqipërinë, na risjellin në kujtesë, amanetin e pavdekshëm të tyre, për ta vazhduar luftën, për të mbrojtur lirinë, për të mosharruar asgjë e asnjëri.

Pikërisht këto amanete të tyre u harruan pas vitit 1990. Arriti puna deri tek këto lista, sepse, ju dhamë liri më tepër se e meritonin, ju dhamë liri edhe atyre që nuk e meritonin. Ju dhamë para, prona dhe komoditet jetese edhe atyre që duhet të jepnin gjithmonë llogari për krimet, turpet dhe tradhëtisë që kishin bërë etrit e tyre. Por le të kthehemi tek numri 65 i kësaj liste me "kriminel" të Tufës e Çelo Hoxhës, se kush është ky dhe çfarë krimesh ka bërë.

Gjon Marashi, i shpallur nga tufat e horrave të horrave nazifashist si "kriminel" lindi në një familje të Dukagjinit me 1895. Ai ishte djali i Marash Pjetrushit dhe nipi i Marash Tuçit, i cili në vitin 1816, 203 vjet më parë, kishte dhënë jetën në Sarajet e pushtuesve në Shkodër në mbrojtje të besës dhe vlerave të tjera të familjes dhe krahinës Dukagjinit. (Sokol Meta, "Studim", gazeta "Nikaj- Mërturi" 2018). Ky akt shërbën në dekada e shekuj si shembull trimërie, patriotizmi dhe vlerë deri në ditët e stome për brezat e ardhshëm. Që nga ajo kohë e sot, jeta e djemëve dhe burrave të kësaj familje ka qënë e njëjtë me hallet dhe fatet e Dukagjinit dhe Shqipërisë.

Gjon Marashi që në moshën 16 vjeçare, përkrah babës vet, rroku pushkën dhe bëhet pjesë aktive e tërë lëvizjeve antiosmane që udhëhiqeshin nga patriotët shqiptarë. Në Korrikun e vitit 1915, ishte ndër djemtë e parë të Dukagjinit, që ju bënë barikadë e pakalueshme, për 27 ditë, forcave turke të Turgut Pashës në atë që njihet si "Lufta e Qafës Agrit".

Gjon Marashi ishte në ballë të forcave përparimtare edhe kundër pushtuesve austro-hungarez e serbe, gjatë Luftës së Parë Botërore, në mbrojtje të territoreve shqiptare në veri të vendit. Ai vazhdoi të rreshtohet gjithmonë në anën e duhur në çdo ngjarje historike. Në shtatorin e vitit 1919, 100 vjet më parë, Gjon Marashi, ishte njeri nga përfaqësuesit e Shoshit në atë Kuvend që njihet si "Beslidhja e Dukagjinit", që u bë në Prekal, e cila, Beslidhja, pati jehonë dhe vlera të mëdha për tërë jetën e Dukagjinit. (Për këtë kam studim të plotë).

Gjon Marashi, ishte pjesëmarrës aktiv në Revolucionin e Qershorit më 1924 dhe përkrahës i Qeverisë së Nolit. Lidhur me këtë, gazetari, studjuesi dhe poeti Hysni Milloshi shkruante: "... Në se Bajram Curri, Gjon Marashi... e të tjerë, do të mbaheshin në mbrojtje të fitores atij Revolucionit... ndoshta fatet e Shqipërisë do të ishin ndryshe... Ndoshta edhe 7 Prilli i vitit 1939 nuk do të vinte. (Hysni Milloshi, gazeta "Zëri i së Vërtetës", Janar 2005).

BINAK VATA I SHALËS - P JESË E PADISKUTUESHME E FOLESË SË KRESHNIKËVE TË SHQIPTARIZMIT

Nga Amerika, në fillim të marsit që kaloi, u njoha me këngën e Binak Vatës. Më lindi ideja, që sapo të kthehem në Shqipëri të bëj një shkrim për këtë lajm shumë të pritur nga unë, por mendoj e besoj edhe për Shalën e Dukagjinin. Të shkruaj për veprimtarinë e tij patriotik, për një kreshnik okëplot të folesë së shqiptarizmit, siç është dhe do të mbetet Binak Vata i Shalës, i cili luftoi për mbrojtjen e trojeve tona nga sulmet e herë pas hershme të huajve, por edhe për zhvillimin e kuvendeve, faljen e pajtimin e gjaqeve.

Binak Vata u lind në Abat të Shalës, në një familje me tradita të larta. Vatush Leka, i ati i Binak Vatës, i cili jetoi pak më shumë se 100 vjet, ishte një burrë që e njohën malet, i kompletuar me cilësitë e malësorit, zemërbardhë, bujar i përmasave të mëdha, që bukë e nder nuk i kurseu kurrë. Vatush Leka la pas një pasuri të madhe njerëzore, për të sotmen dhe brezat që vinë. Kjo pasuri mund të përmbledhet në këto drejtime:

- Bukë e nder nuk i kurseu kurrë.
- Shpirti i tij bujar bëri që shtegtarët, në shenjë bekimi, të thërrisnin një copë vend rreth shtëpisë së tij "pushima".

Vatush Leka krijoi një sistem huadhënie për fukaranë, i emërtuar "hua nën hua", që ndryshonte nga të gjithë të tjerët të kohës së tij. Cilido që jepte hua caktonte kapitalin themelor të huas si dhe renten (fitimin) që do të vilte në mbarim të afatit. Ndërsa Vatush Leka caktonte kapitalin themelor të huas, por pa rent (pa fitim). Psh. njërit i jepte 50 okë drithë sipas kërkesës, dhe huamarrësit jo vetëm që nuk i merrte fitimin, por i falte edhe 15 okë drithë nga kapitali themelor. Këtu qëndron thelbi i huas nën hua.

Vatush Leka toleronte edhe në kthimin e kapitalit themelor duke ia shtuar afatin e mbajtjes së huas. Vatush Leka jepte hua drithëra buke, patate, grosh, djathë, mish, dhe lekë. Ky sistem huadhënie, i cili ishte

vetëm për Vatush Lekën, nuk ekzistonte në asnjë vend tjetër në kohën e tij dhe nuk ka ekzistuar as më vonë, nuk ekziston as sot, dhe s'ka asnjë shans të ekzistojë në të ardhmen. Veprimtaria e Vatush Lekës,



si bujar i përmendur për kohën, por edhe i mbetur për të gjitha kohërat si fenomen shumë pozitiv, i veçantë dhe shumë edukativ, e bënë këtë malësor të pavdekshëm. Është krenari për të gjithë farefisën e tij, e

psë jo edhe për Shalën e Dukagjinin. Do të ishte e efektshme të shikohet mundësia e vendosjes së një pllake përkujtimore për Vatush Lekën, me mbishkrimin:

- Bukë e nder nuk i kurseu kurrë.
- Shtegtarët, në shenjë bekimi një vend në oborrin e tij e emërtuan pushima.
- Krijoi një sistem huadhënie për të varfrit, që u quajt hua nën hua.

As mbi varret e njerëzve të njohur botërisht, si politikan, si pedagog apo profesor, nuk ka edhe një pakicë me shumë vlera mbishkrimi i tyre se vlerat e mbishkrimit në pllakën e Vatush Lekës.

Binak Vata i Shalës, u lind në një vatan me tradita dhe zakone të larta, të cilat, pa dyshim, u bënë burim i madh edukimi për Binak Vatën.

- Asnjëherë kjo derë nuk mbeti pa një orë

- Nuk mbeti pa një djalë, që t'i ruante trollin, besën edhe fjalën e për të rrit namini që patën

- Nëna lindi Binak Vatën.

Qysh i vogël, Binak Vata dha shenja për hijeshi të këndshme, e më vonë djalë krenar, burrë azgan. Veshja me tirq të bardhë e xhamadan, e bënin Binak Vatën, me të vërtetë një kolos, që as kreshnikët e Jutbinës nuk mund t'ia ndalnin turrin.

Binak Vata me qelibar e kuti bademi, jo rastësisht u bë krahu i djathtë i Mehmet Shpendit, Udhëheqësit të Djemisë së Shalës, i të parit organizim politik të kohës së këtij lloji në vendin tonë, tregon se Binak Vata i besonte vetes së tij organizues e drejtues si prijës popullor, por edhe shpirtit atdhetar të tij, se duke u bashkuar me figurën më të madhe të kohës do të bënte që kontributi i tij do të rritej në përmasa më të mëdha në luftën për mbrojtjen e trojeve nga sulmi dhe invadimi i të huajve në malësi tona. Bashkëpunimi me Çun Nikën e Marash Delinë, tregon se Binak Vata gjurmonte dhe kërkonte të zgjeronte gamën e bashkëpunimit midis luftëtarëve

inclin" Gjon Marashi, janë vetëm disa episode nga jeta dhe veprimtaria e tij mbi 77 vjet jetë aktive.

Për disa nga historitë, tiparet, cilësitë, vlerat, humanizmin, humorin, patriotizmin, paraqitjen, uniformën dhe armët, fisnikërin, bujarinë, krenarinë, por edhe kokëfortësinë lidhur me atë që mendonte e gjykonte se është më e drejta dhe më e mira, Gjon Marashi, ka tërhequr vëmendjen e jo pak krijuesve si: shkrimtar, poet, gazetar, fotograf, rapsodë dhe këngëtar si: Hysni Milloshi, Dritëro Agolli, Prel Milani, Halil Kata, Lirim Deda, Dodë Kaçaj, Mark Pal Guri, Gjon Kosteri, Ndoc Selimi, Sami Guzina, K. Marubi, Sh. Pici, Rr. Berisha, P. Cici, Foto Stamo, madje edhe gazetar dhe fotograf të huaj, duke

paraqitur tipare dhe anë e veçanta të tij. Gjatë jetës së tij u nderue me 11 dekorata nga forumet më të larta të kohës. Janë të pakta ato familje, jo vetëm në Dukagjin, por edhe më gjërë të ngritura deri në piedestalet e nderit e të pavdeksisë në poezi e këngë ku drejtpërdrejtë, të përveçme dhe të përbashkëta, sikur koha i kishte thirrur në skena betejash, dhe ata, kohës, i lanë veprën dhe emrin e vet.

Për të gjitha këto arsye, unë nipi i "kriminelit" Gjon Marashi, them se: çdo emër në atë listë i cilësuar si "kriminel" është një marrëzi me veti. Ndërsa e tërë lista, është një precedent i padëgjuar në asnjë vend tjetër. Të luftosh për lirinë e vendit tënd, kundër të huajve që të kanë pushtuar, dhe të shpalleh "kriminel"

nga bashkëatdhetarët e tu, është çudi dhe çmenduri e asaj çete me hora. Më qartë kjo do të thotë: "Mos e duaj atdhetu tënd.. Bëhuni edhe ju tradhëtar si ne..." Kjo është e padëgjuar. Ky është një turp i një lloji të padëgjuar. Ky është një krim i pafalshëm. kjo nuk duhet të falet.

Po të kishin gojë, edhe malet e Dukagjinit do ta pyesnin anëtarët e kësaj çete brekushzinjsh që kanë formuar këto lista me "kriminel" përse e akuzoni këtë farë trimi? Gjon Marashi, ishte ndër ata burra, trima e atdhetar më me kontribut të spikatur për lirinë dhe përparimin e Dukagjinit në shekullin e kaluar dhe më i spikatur në brezin e vet. Ata që kalojnë andej dhe e njohin historinë e Dukagjinit dhe burrave të tij edhe sot ju duket sikur jehojnë

zërat e kushtrimit dhe krismat e armëve të plejadës burrave si Gjon Marashi, për të mbrojtur vendin nga armiqtë, fjalën e mençur dhe në kohë, në mbrojtje të lirisë dhe të përparimit Dukagjinit e mbarë Shqipërisë. Ai me shembullin e vet, edhe nga varri ju thërret brezave: "Mos i harroni armiqtë, mos ja besoni të huajve lirinë, se Dukagjini e tërë Shqipëria, është toka jonë që të parët na kanë lënë". Gjon Marashi nuk pranoi kurrë për të shpallur flamurin e bardhë të dorëzimit, pas të cilit, velloja e zezë e qejfinit vdekjes të mbulonte Shqipërinë. Ai qëndroi besnik i zgjidhjeve të veta si burrë trim, doli fitimtar dhe mbeti i paharruar në kujtime e këngë. Dhe populli, nuk të futë në këngët e veta po nuk e meritove.

